



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1168

OSHP: 2025/1170

OSHP: 2025/1180

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Muhamet Muçiqi”, OE “VIA EGNATIA” SH.P.K., si dhe OE “AGRO INVEST 1” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të "KOMUNA E PRISHTINËS", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunes së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, me 10.02.2026, mori:

Vendim

I. Aprovohen si pjesërisht të bazuar ankesa e OE “Muhamet Muçiqi BI” me nr. 2025/1168 si dhe ankesës së OE “Via Egnatia shpk” me nr. 2025/1170 si dhe ankesës së OE “Agro invest 1 shpk” me nr. 2025/1180, kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunes së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës.

II. Mbetet në fuqi , B58Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit sipas diapozitivit I të këtij vendimi.

III. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtoj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 13.03.2025, “KOMUNA E PRISHTINËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 780,000.00 €.

Me 11.11.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për dhënie të kontratës.

Me 17.11.2025, OE “Muhamet Muçiqi” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Me datë me datën 17.11.2025, “VIA EGNATIA” SH.P.K me 14.11.2025 OE “AGRO INVEST 1” SH.P.K kan parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues për dhënie.

Me 19.11.2025 Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilin ka refuzuar si të pa bazuara ankesat e Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 30.11.2025, OE “Muhamet Muçiqi” ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2025/1168 me datë 30.11.2025 OE “VIA EGNATIA” SH.P.K ankesën me nr.2025/1170 me datën 01.12.2025 “AGRO INVEST 1” SH.P.K ankesën me nr.2025/1180, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr te 616-25-1830-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të tri ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 1168-1170-1180/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, më parë janë nxjerrë disa vendime nga OSHP-ja, konkretisht vendimet me numrat: OSHP 2025/0643, OSHP 2025/0657, OSHP 2025/0660 dhe OSHP 2025/0661, të gjitha të datës 16.09.2025

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Muhamet Muçiqi” janë parashtruar si në vijim:

AK – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES me datë 01.07.2025, përmes platformës elektronike e-prokurim merr vendim - 058 Njoftimi mbi vendimin e AK, që do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, dhe Rreg. Nr. 001/20222 për PP të cilat do i argumentoj dhe dëshmojmë me prova dhe fakte konkret si në vazhdim të kësaj KpR. Pas refuzimit të KpR kemi vazhduar me ankese në OSHP, ku PSH ka nxjerr vendimin me nr. 2025/0661 duke aprovuar në teresi dhe ka kthyer Lenden në Rivleresim me datë 16.09.2025

AK – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES: PAS RIVLERESIMIT me datë 11.11.2025, përmes platformës elektronike e-prokurim merr vendim - 058 Njoftimi mbi vendimin e AK, që do thotë se me këtë rast PERSERI ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, dhe Rreg. Nr. 001/20222 për PP të cilat do i argumentoj dhe dëshmojmë me prova dhe fakte konkret si në vazhdim të kësaj KpR.

Andaj, duke marrë për bazë dispozitat ligjore të nenin 4 të LPP-se në si GOE me pale me interese sipas nenit 4 par. 1.26 të LPP-së, edhe për kundër faktit se në kemi arritur të plotësojmë të gjitha kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosje tenderit dhe njoftimin për kontratë (DËSHMI SQARIMET me datë: 23.10.2025), mirepo AK – Komisioni i RI-vlerësimit – ZPP duke shkelur dispozitat ligjore të LPP së, duke na eliminuar padrejtësisht, duke në diskriminuar në detyrohemi të parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim pranë AK duke pasqyruar dhe një herë faktet dhe argumentet kundër LETRSES STANDARDE TË ELEMNIMIT, për faktin se AK – ZPP dhe Komisioni i RIVELRESIMIT kanë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, duke na eliminuar kundër kornizës ligjore në FUQI të LPP-se.

NË SI GOE arumentojmë dhe KONSTATOJME se të gjitha dokumentacionin e kërkuar për këtë AP janë në pajtim të plotë me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë – duke plotësuar në teresi kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin kryesor të dhënies së kontratës – çmimi me të ulët i përgjegjshëm. Pasi që qëllimi i vetëm i AK – ZPP dhe Komisionit të vlerësimit, ekzamnimit dhe krahasimit të tenderve të bëjnë të pamundurën dhe të gjejë arsye të eliminimit të GOE me çmimin me të ulët të përgjegjshëm, që kemi tender në vlerë: 69.59 € dhe të reagojmë duke eliminuar GOE me çmimin me të lartë në këtë AP në vlerë: 167.64 € - (Ky veprim i AK – ZPP Komisioni të vlerësimit është tendencioz dhe në shkelje të kodit të etikës dhe parimeve të prokurimit konkretisht “VLERES PER PARA” sepse të rekomandohet një GOE me çmim afërsisht mbi 140% me të lartë se sa Oferta jone (MBI DYFISHIN E ÇMIMIT TONË) duke demtuar

BUXHETIN e Republikës së Kosovës në këtë masë është shqetësuese dhe DISKRIMINUSE , kur dihet se shumë lehtë AK – Komisioni i RI-vlerësimit ka mund të vepron sipas KORNIZES LIGJORE NË FUQI, konkretisht Dispozitave ligjore të LPP-se, të theksuara tek “Dispozitat ligjore të shkelur nga AK” në këtë KpR në faqe 2 dhe 3

Prandaj, AK – Komisioni i RI-vlerësimit, ekzamnimit dhe krahasimit të tenderve nga e VENDIMIT nga PSH me nr. 2025/0661 të datës 16.09.2025 ka vazhduar duke shkelur nenin 30.4 të Rregullores nr. 001/2022 për PP (p.sh. RI-vlerësimi i tenderit ka zgjatur 56 ditë duke tejkaluar afatin ligjor sipas LPP[1]se).

Pra nga kjo mund të vijim në përfundim se qëllimi ka qenë se si me dalë tek GOE me çmimin me të lartë dhe për na eliminuar krejt padrejtësisht duke shkelur Dispozitave ligjore të LPP-se, të theksuara tek “Dispozitat ligjore të shkelur nga AK” në këtë KpR në faqe 2 dhe 3

Prandaj kërkojmë nga AK -ZPP– Komisioni i RI-vlerësimit të APROVOJNE KpR tone dhe të kthejnë në rivlerësim këtë AP për faktin se GOE që kemi tenderuar dhe kemi jap sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-se duke permbushë kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, si dhe jemi GOE i përgjegjshëm me çmimin me të ulët, sipas nenit 30.1 të FDT-së

AK me rastin e eliminimit të kompanisë tone – GOE për aktivitetin të prokurimit përmes njoftimit 058 vendimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit duke na shpallur përmes letres standarde të eliminimit si GOE TË ELEMINUAR. Të cilat ARSYTIME NUK QENDROJN dhe janë në shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së.

Në tani po ngjisin disa pretendimet ankimore dhe disa arsyetime KONSTATIME në këtë AP – Procedure të Prokurimit, si më poshtë:

Pretendimi: 1

Autoriteti kontraktues – komisioni i RI-vlerësimit – në Komunen e Prishtinës, me rastin e eliminimit përmes B42 - letres standarde të eliminimit të datës; 11.11.2025, në shkelje të LPP-së po japim arsyetime si më vijim:

AK jep këtë arsyetim anulimi: - Tenderi juaj është refuzuar për këto arsyetime:

Ju si GOE-ik nuk keni dorëzuar specifikimet teknike të cilat kanë qenë të bashkangjitura me dosjen e tenderit (Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUSHME – Sipas përshkrimit teknik – Parametres dhe skicave të projektit të bashkangjitura në DT), andaj tenderi juaj është refuzuar duke u bazuar në UDHEZUSIN Nr. 001/2023 PËR PROKURIM PUBLIK, UDHEZUESIN Nr. 002/2024, PËR PLOTESIM NDRYSHIMIN E UDHEZUSIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ku thuhet: “Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“specifikimet teknik” – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në rastet kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar)

Veprimi: Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshme, Neni 28 i LPP-se Aneksi 1 është pjesë përbërëse e DT-se

Pretendimi ynë se bashku me arsyetim duke argumentuar dhe faktuar shkeljen e LPP-së nga AK si më vijim:

Vlerësimi, ekzamini dhe karahasimi i tendereve nga Komisioni i tendereve duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik. Në përgjithësi, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të veprojë në përputhje me nenin 7 të LPP-së (trajtim i barabartë), nenin 59 (vlerësimi i ofertave sipas kriterëve të përcaktuara) dhe nenin 60 (përzgjedhja e ofertës më të ulët të përgjegjshme), duke u bazuar në kriteret që vetë i ka vendosur në Dosjen e Tenderit. Çdo vlerësim që devijon nga këto parime mund të cenojë konkurrencën e ndershme dhe integritetin e procesit të prokurimit. Për faktin se AK në dosjen e tenderit ASKUND NUK KA KERKUAR që operatorët ekonomik me rastin e tenderimit të dorëzojnë DEKLARAT MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE apo/ose të dorëzojnë përshkrimin teknik i rrethojave (ku AK ka vendosur tek “dokumenti shtojcë” tek dosja e tenderit me rastin e publikimit), po ashtu edhe në dosjen e tenderit në asnjë pjesë të saj nuk është kërkuar që OE

duhet te dorezojn deklarat apo specifikime teknike te nenshkuar dhe te vulosura, prandaj as tek FLETA E TE DHENAVE TEK DOSJA E TENDERIT SI DHE AS TEK ANEKSI 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE NE DOSJE TENDETRIT - Me fjale tjera AK me rastin e hartimit te dosjes se tenderit tek kriteret e përzgjedhjes (Kërkesat mbimundësitë teknikedhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 te FDT-se) nuk ka kërkuar/specifikuar se OE duhet te dorezojn specifikime teknike si dhe as deklarat mbi specifikimet teknike.

Prandaj KY arsyetim i dhen ne letren standarde per elemnimin e GOE tone eshte ne shkelje te kritereve te përzgjedhjes te percaktuar ne Dosje tenderit, ne aneksin 1 te FDT-se dhe eshte ne shkelje te nenit 7, 59 dhe 60 te LPP-se. Ky arsyetim i dhen nga AK – Komisioni i RI-vleresimit nuk qendron dhe nuk gjene mbeshtetje ne asnjë dispozite ligjore te LPP-se dhe nen asnjë dokumente te tenderit per kete AP si dhe as ne DT dhe NJK, prandaj LUSIM – ZPP – ESH-PSH te analizoj dhe te aprovoj KpR dhe te kthej ne Rivleresim – duke u bazuar ne fakte dhe argument te mbeshtetura ne dispozite Ligjore te LPP-se dhe te na rekomandoj per dhenie te kontrates, sepse ne kemi dorezuar Formularin e tenderit ku kemi argumentuar dhe jemi pajtuar me te gjitha dokumentet e tenderit, “përshkrimi teknik i rrethojave” dhe dot e realizojme ekzekutojem ne përputhje te plote me menyren e kërkuar tek përshkrimi dhe vizatimet dhe nevojën e AK ne teren me standardet me te larta ten dertimit, ashtu sic kemi realizuar edhe eekzektuar disa kontrate me AK – Komunen e Prishtines ne vitet paraprake dhe per te cilat kemi marr referenca pozitive per ato kontrata dhe projekte. Prandaj ky arsyetim i dhenë nga AK nuk qendron aspak, por jemi eliminuar padrejtësisht dhe ne shkelje te dispozitave te LPP-së.

Provë: DT, NJK, doumentet e ngritur ne e-prokurim per kete AP – skicat. PERSHKRIMI TEKNIK I RRETHOJAVE.pdf

Pretendimi: 2

Autoriteti kontraktues – komisioni i RI-vleresimiti –ne komunën e Prishtines, me rastin e eliminimit permes B42 - letres standarde te eliminimit te dates; 11.11.2025, ne shkelje te LPP-së po japim arsytme si ne vijim:

Ju si GOE-ik jeni te papergjegjshemper faktin se nuk keni dorezuar Deklarata nen betim nga tenderuesit duke përdorur formen e percaktuar ne Dosjen e Tenderit Aneksi 2.

Anetaret e konsorciumit HARST GROUP SHPK & VALDRINI SHPK, nuk kane përdorur formen standarde te percaktuar ne dosjen e tenderit, perkatesisht Deklaraten nen betim, por kane ofruar nje dokument/formular te modifikuar nga OE, gje qe bie ne kundërshtim me kerkesen e lartcekur te Dosjes se tenderit, ku per kete qeshtje shuem qarte eshte cekur edhe sipas RREGULLORES NR, 002/2024 PER PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PER PROKURIM PUBLIK (Versioni i Konsoliduar), Formularet standard te tenderit, perkateisht me nenin 44.3, e cil eshte ne fuqi nga data 11.11.2024).

Neni 44.3 i Rregullores dhe Udhëzuesit operativ per prokurim publik percaktonsi ne vijim: “Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët Ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header” apo kudo tjetër në dokumentet standarde”.

Andaj, AK konsideron se bazuar ne dispoziten e larte cituar, Operatoreve Ekonomik nuk ju lejohet te bejane kurrfare ndërhyrje me Format Standarde duke shtuar, ndryshuar apo modifikuar ndonje informate apo kusht qe dot e rezultante me ndryshimi e permbajtjes se tij.

Pretenimi yne se bashku me arsyetim duke argumentuar dhe faktuar shkeljen e LPP-së nga AK si ne vijim:

Vleresimi, ekzamnimi dhe karahasimi i tendereve nga Komisioni i tenderve duke u bazuar ne kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik. Në përgjithësi, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të veprojë në përputhje me nenin 7 të LPP-së (trajtim i barabartë), nenin 59 (vlerësimi i ofertave sipas kriterëve të përcaktuara) dhe nenin 60 (përzgjedhja e ofertës më të ulët të përgjegjshme), duke u bazuar në kriteret që vetë i ka vendosur në Dosjen e Tenderit. Çdo vlerësim që devijon nga këto parime mund të cenojë konkurrencën e ndershme dhe integritetin e procesit te prokurimit.

Lidhr me kete arsyetim nga AK – Komisioni i RI-vleresimit bazuar ne “Deklarate nen Betim” te dorezuar nga antaret e konsorciumit shume qarte KONSTATOHET dhe argumentone se ato deklarate jane ne përputhje te plote me nenin 44.3 te Rregulore Nr. 011/2022 per Prokurim Publik (versioni i konsoliduar) per faktin se Antari: HARST GROUP SHPK ka dorezuar deklaraten enn betim pikrisht duke shtypur nga dosje e tenderit, por vetem ne “HEDER” te deklarates ka vendosur titullin dhe numrin e prokurimit duke mos ndryshuar asnjë gje ne permbajtje, kufizim apo kushte shtese, ose fshire ndonje kushte te percaktuar nga AK. Prandaj Anetari i konsorciumit e ka dorezuar ne përputhje te plote “Beklartaten nen Betim” ashtu sic e përcakton neni 44.3 i kësaj rregullorje duke vendoe vetem ne “Heder” emrin e projekti dhe numrin e prokurimit pasi qe kjo eshte e lejuar dhe nuk eshte ne kunderhstim me rregulloren ne fjale. Ndersa Antari tjeter VALDRINI SHPK, po ashtu ka dorezuar “Deklaraten nen Betim” ne përputhje te plote me nenin 44.3 te rregullores ne fjale pasi qe nuk ka ndryshuar asnjë gje ne permbajtje, kufizim apo kushte shtese, ose fshire ndonje kushte te percaktuar nga AK, por vetem tek “Heder” ka mbet numri “1” dhe “8” duke shkruar numrin e prokurimit por me rastin e printimit nuk ka dal i plote, prandaj kjo eshte e lejuar me nenin 44.3 te rregullores en fjale dhe nuk perben asnjë ndryshim apo plotesim qe te mund te eliminohet, sepse te gjitha kushtet tjera jane sipas Dosjese se tenderit ANEKSI 2 . Prandaj ky arsyetim i dhenë nga AK nuk qendron aspak, por jemi eliminuar padrejtësisht dhe ne shkelje te dispozitave te LPP-së.

Provë: Dejkaratet nen betim nga Antaret e Konsorciumit Harst Group Shpk dhe Valdrini SHPK

Pretendimi: 3

Autoriteti kontraktues – komisioni i RI-vleresimti –ne komunën e Prishtines, me rastin e eliminimit permes B42 - letres standarde te eliminimit te dates; 11.11.2025, ne shkelje te LPP-së po japim arsytime si ne vijim:

Ju si GOE-ik keni paraqitur oferte qe permban pozicione me cmime normalisht te uleta dhe permes B41 - Letres Standarde e kërkesë per informata mbi tenderet jo-normalisht te ulete me date 20.10.2025. Në përputhje me nenin 61 te Ligjit nr. 04/l-042 per Prokurim Publik dhe Rregullores e prokurimit publik, paragrafi 41.6. Autoriteti Kontraktues ka kerkuar qe te paraqesni me shkrim sqarimet e nevojshme dhe arsyetimin e detajuar per formimin e cmimeve per pozicionet qe jane identifikuar si cmime potencialisht normalisht te uleta.

Ju si GOE-ik jeni pergjigjur me date 23.10.2025. AK konsideron se sqarimet e ofruara per pozicionin 2 nuk jane bindese per AK sepse sqarimet e ofruara nga ju, ku theksoni se eshte biznes familjar dhe kosoto per fuqi punetore po ashtu edhe per makineri eshte e perballushme me çmimin e ofruar, ju sipas dokumentacionit te ofruar ne fazen e ofertimit nuk korrespondon me sqarimi e dhene, sepse ne oferte nuk jane te cekur se cilet nga stafi ose punetoret e prezantuar jane familjar e po ashtu edhe te makineria e prezantuar pjesa dërmuese jane me kontrata per marrjen ne shfrytëzim. Sqarimet e ofruara per pozicionet sipas paramases 3, 4 dhe 5 nuk jane bindese per AK sepse ju me rastin e oferimit te sqarimeve keni ofruar cmimet e tregut te dates kur ne si AK kemi kerkuar sqarime dhe jo para dates se hapjes se ofertave kur edhe ju keni konkurruar me ato cmime, andaj sqarimi juaj per keto pozicione nuk llogaritet i pranushem per AK-ne sepse nie ndesh me vet oferten e dorezuar nga ana juaj.

Andaj, edhe per arsye te cekura me larte jeni eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Pretenimi yne se bashku me arsytim duke argumentuar dhe faktuar shkeljen e LPP-së nga AK si ne vijim:

Vleresimi, ekzamnimi dhe karahasimi i tendereve nga Komisioni i tendereve duke u bazuar ne kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik. Në përgjithësi, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të veprojë në përputhje me nenin 7 të LPP-së (trajtim i barabartë), nenin 59 (vlerësimi i ofertave sipas kriterëve të përcaktuara) dhe nenin 60 (përzgjedhja e ofertës më të ulët të përgjegjshme), duke u bazuar në kriteret që vetë i ka vendosur në Dosjen e Tenderit. Çdo vlerësim që devijon nga këto parime mund të cenojë konkurrencën e ndershme dhe integritetin e procesit te prokurimit.

Lidhur me arsyetimin e dhene per eleniminin tone lidhur me çmimin per poz. 2 ne paramas dhe parallogarit ku vete AK e potencon po citojm: “sepse ne oferte nuk jane te cekur se cilet nga stafi ose punetoret e prezantuar jane familjar e po ashtu edhe te makineria e prezantuar pjesa dërmuese jane me kontrata per marrjen ne shfrytëzim” ku dëshmohet dhe argumentohet dhe vete AK e pranon se m erastin e vlerësimit, ekzamnimit dhe krahasimit te tendereve nuk ka vleresuar drejte dhe ashtu sic percaktojn dispozitat ligjore te LPP-se, duek na diskrimnuar dhe duke mos na trajtuar barabart, sepse ne kemi prezantuar listen e punetoreve te angazhuar nga Lideri i grupit ku pjesa me meadhe e tyre jane familjar dhe kjo qarte vrehet dhe argumentohet, NESE AK nuk e ka pas te qart ashtu sic vete potencon ne arsyetimin per eleniminin tone sigurisht ka mundur te kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, dhe sigurisht dot e ja kish dhen pergjigjie dhe bere te qarte, dhe jo te nxjerr vleresime dhe konstatime kur vete AK – komisioni i vlerësimit nuk e kat e qarte, dhe q ene besojm ne per te gjithë punetoret qe kane kontrata apo parakontrat nga lideri i grupit jane familjare pasi qe lideri ka pergjegjesin kryesore dhe perqindejn me te madhe per rezliaimin e kësaj kontrate athere kjo nenkuptohet dh sigurisht eshte e qarte edh eper AK – komisionin e vlerësimit prandaj lusim ZPP te kthej ne rivlerësim te aprovoj KpR te parashtruar nga ana jone dhe te vlerësoj, ekzaminoj dhe krahasoj oferten tone ne përputhje te plote me fryme e Ligjit te Prokurimit Publik dhe te mos nxjerr përfundime/vleresime te paqarta dhe te pa argumentuar, por te vleresoj dhe gjykoj drejte duke u mbështetur ne dispozite ligjore te LPP-se, konkretisht nenin 6, 7, 59 dhe 60 te LPP-së.

NE me rastin e sqarimeve te dhena me daten 23.10.2025 lidhur me cmimet jo normalisht te uleta kemi zbërthyer dhe analizuar ne detaje duke percaktuar te gjithë kostot qe rrjedhin ne ekzekutimin e kësaj kontrate qofte furnizimet , shërbimet dhe punet qe dot e realizohen ne tere dhe kemi shpjeguar ne menyre profesional deh te detajuar gjithë koston e furnizimeve, dhe

puneve si dhe fitimi yne nga kjo kontrate, duke i shpejguar detajisht per pozic. 2, 3 4 dhe 5

ne përputhje te plote me nenin 41.8 te RREGULLORES NR. 002/2024 PER PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PER PROKURIM PUBLIK (Versioni i Konsoliduar).

Ndersa, arsyetimi i dhene nga AK per eliminimin tone sa i perket cmimeve jo-normalisht te uleta ku ka dhen enje arsyetim po citojm: “Sqarimet e ofruara per pozicionet sipas paramases 3, 4 dhe 5 nuk jane bindese per AK sepse ju me rastin e oferimit te sqarimeve keni ofruar cmimet e tregut te dates kur ne si AK kemi kerkuar sqarime dhe jo para dates se hapjes se ofertave kur edhe ju keni konkurruar me ato cmime, andaj sqarimi juaj per keto pozicione nuk llogaritet i pranushem per AK-ne sepse nie ndesh me vet oferten e dorezuar nga ana juaj”, andaj ky arsyetim i dhen nga AK – komisioni i vlerësimit nuk gjene zbatim ne ligjet ne fuqi dhe ne asnjë dispozite ligjore te LPP-se, per faktin se ne me rastin e përcaktimi te cmimeve (data e dorëzimit te tendereve 18.04.205) SIGURISHT kemi hulumtuar dhe analizuar cmimet dhe kemi vendosur ashtu sic kemi dhen cmim ne paramas dhe parallogarit – formular te tenderit, mirepo nuk kemi mundur te PARAGJYKOJME vlerësimin e AK – komisionit te vlerësimit se do ti trajtoj si cmime jo normalisht te uleta, POR VETEM KUR KA KERKUAR SQARIME ME DATE 20.10.2025, ne ne pajtim me nenin 41.8 te Rregullores nr. 001/2022 per PP kemi ofruar sqarimet e DETAJUARA, duek ofruar edhe prova dhe fakte konkrete, nga furnitoret tane qe bashkpunojm vazhdimisht qe disa vite dhe qe kemi realizuar kete natyre te njëjte te kontratae pikreosht me AK – Komunen e Prishtines, sepse ne jemi kompani e specializuar per kte natyre te puneve. Prandaj arsyetim se “cmimet e tregut te dates kur ne si AK kemi kerkuar sqarime dhe jo para hapjesese ofertave” eshte arsyetim qe nuk gjene mbeshtetje ne LIGJIN E PROKURIMIT PUBLIK , si dhe ne asnjë ligjit tjeter qe eshte ne fuqi ne RKS, prandaj ky arsyetim eshte ne shkelje te qellimit te prokurimit per kete AP, duke shkelur nenin 1 , 6 dhe 7 te LPP-se, Prandaj ky arsyetim i dhenë nga AK nuk qendron aspak, por jemi eliminuar padrejtësisht dhe ne shkelje te dispozitave te LPP-së.

Gjitashtu, duke pasur parasysh keto zgjidhje teknike qe ne rastin e përcaktimit te cmimeve nga ana jone me date: 18.04.2025 ne jami favorizuar te ofertojm me keto cmime. Duke i marr per baze te gjitha sqarimet qe i kemi dhene me daten 23.10.2025, duke jap prova dhe fakte konkretet e dëshmuar me rastin e tenderimti me stafin tone te prezantuar nga lideri, si dhe me makineri qe posedojem si lideri i grupi, por edhe nga kapacitetet teknike profesional dhe makineri nga anteret e grupit me te cilet kemi nje bashkëpunim afategjate dhe profesional ne realizmin e shume projekteve te ndryshme ne nivel vendi dhe me Komunen e Prishtines, ku te gjith keto jane fakte dhe prova konkrete ju kemi garntuar se cilesia sipas paramases dhe parallogarise nga AK do te ekzekutohen sipas kushteve te pergjitheshem dhe te veqanta te kontrates.

Gjithashtu, duke marr per baze se ky aktivitet i prokurimit ka nje vlere te larte te parashikuar si dhe pershkrimi i cimimeve eshte me poetim, ku sasi e parashikuar eshte 1 (nje) copë dhe vlere e sigurimit te ekzekutimit eshte e larte 10% e vleres se parashikuar qe siguron dhe garanton AK se ekzekutimi i kesaj kontratë nuk do te deshtoj, ne jemi GOE te specializuar dhe te profesional ne ekzekutimin e kotratve te kesaj natyre, (SIKUR TE KEMI NDONJE DYSHIM SE NUK DO TE REALIZOJME KETE KONTRATE APO EDHE PARAQET VESHTIRESI) por paverishte vleres se larte te sigurimit te ekzekutimit per arsye te besimit dhe per te siguruar AK ne jemi te pajtim qe AK te veproje sipas nenit 29.4 te Rregullores nr. 001/2022 per PP – (version i konsoliduar) po citoj: “Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës, ndërsa të kontrata me çmim për njësi apo me poentim kërkohet 10% e

vleres se parashikuar. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, AK do të siguroj që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Autoriteti kontraktues, pasi që të jetë përputhur me nenin 61 të LPP-se, ka mjaft arsye për të besuar se Operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht të ulet), gëzon të drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit të ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata”.

Gjithashtu, Ne jemi te gateshem te rrisim shume e sigurimit te tenderit ne perputhje ne dispozitat ligjore te LPP-se, si ne sqarimin me lartë, ne menyre qe te sigurohet AK dhe te perdore mundesit ligjore dhe te merrn per baze te gjitha asytimet tona me larte duke pasur parasysh gjithashtu edhe nenin 1 dhe 6 te LPP duke kursyer buxhetin e Komunes se Prishtines, dhe jo te na eliminoj padrejtësisht dhe me arsyetime te cilat nuk gjejne mbështetje ne dispozita te LPP[1]se, duke shkelur nenin 61 te LPP-se dhe nenin 41 te Rregullores ne fjale.

Prandaj duke e pasur parasysh te gjithë arsytimet dhe deshmit tone qe ne jemi veqanarisht te favorizuar te ofertojme me keto cmime ne pajtim te plote me dispoziten ligjore nenin 41.8 te Rregullores nr. 001/2022 per PP – versini i konosliduar, ne besojm ne mirkuptimin dhe besimine AK qe te veproje ne pajtim ne dispozitat e LPP-se dhe te na shperblej me kontrate ne kete aktivitet te prokurimit ne pajtim te plote me te gjitha dispozitat ligjore të LLP-së.

Provë: Sqarimet e dhene per AK lidhur me cmimet jo normalisht te uleta te dates 23.10.2025

Pretendimet tona për GOE te rekomanduar për dhënie te kontrates:

Pretendimi: nr. 1

Duke marr per baze aneksin 8 te FDT-se lidhur me makinerit qe ka qene i Obliguar te dëshmoj GOE i rekomanduar nga AK – Komisioni i RI-vlerësimit pas qasjes dhe analizimit te ketyre paisjeve konstatojme se OE i rekomanduar per kontrat i mungojne keto paisje ashtu sic potencon edhe ESH ne raportin nr. 2025/0661 te dates 29.07.2025, dhe VENDIMIN e PSH nr. 2025/0661 te dates 16.09.2025, KU aprovohet anekse jone si e bazuar dhe PSH pajtohet me reaportin e Ekseprtit shqyrtues duke ja fale besim, mirepo KOMISIONI I RIVLERESIMIT edhe per kunder Vendimit te PSH qe eshte pjtuar me raportin e ESH i cili pas shqyrtim vlerëson ne pretendimin nr. 6 faqe 14 te raportit ne fjale si ne vijim:

d) Kamionet për bartjen e mbeturinave

OE ka dorëzuar librezë për një mjet tip kamionetë (dubelkabinë), e shoqëruar me fotografi, porpa dokumentacion që dëshmon funksionalitetin për bartjen e mbeturinave (si kontenier, mekanizëm ngritës, etj). Prandaj, ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, pas qasje rezulton se ky operator nuk ka plotësuar në mënyrë të rregullt pasi qe tek lista e stafit te dorezuar tek follderi 8.1 Lista e makinerise pjesa 1 tek folder nr. 10. N&B shpk, ka prezantuar Kamionet.pdf me targa: 02-354-FL, ndersa ne librezte te qarkullimit shkruan Ndertimi: Kamionet Dubelekabin me 3 dyer, qe NUK E PLOTESON Aneksin 8 te FDT-se, per faktin se Nuk eshte sipas kerkesen ne Aneksin 8 nr. 10 - Kamionet per bartjen e mbeturinave.

Ndersa ne kemi ne kemi dorezuar librezen e qarkullimit ku shkruan Ndertimi: Kamionet dubelkabine per bartjen e mbeturinave me 3 dyer, me taraga: 01-529-NT. Prandaj Komisioni I

RI-VLERESIMIT, nuk ka kerkuar fare sqarime nga GOE i rekomanduar per kontratë per faktin se “Kamioneta per bartjen e mbeturinave” nuk eshte sipas Ankesit 8 te FDT-se, per faktin se GOE te rekomanduar per kontratë ka prezantuar vetem kamionet dubel kabin me 3 dyer, po jo edhe sipas Aneksit 8 te FDT-se, ku eshte kerkuar “Kamionet per bartjen e mbeturinave”, ashtu sic e kemi prezantuar ne me rastin e dorezimit te tendeve. Prandaj Komisioni i RI-vleresimit nuk ka Respektuar Vendimin e PSH nr. 2025/0661 te dates 16.09.2025, duke shkelur nenin 97. pika h. te Rregullores nr. 001/202 per PP – versioni i konsoliduar, per faktin se KOMISIONI I RI-VLERESIMIT nuk kerkon sqarime fare dhe e pranon kete “Kamionet” ne kundërshtim me Aneksin 8 te FDT-se qe dot e thote se GOE i rekomanduar per Kontrate ESHTË i PAPPERGJEGJSHËM DHE DUHET TE ELEMNIOHET, dhe jo te rekomandohet per dhenie te kontrates. Në këto kushte, GOE I rekomanduar per kontrate ne kete AP është bërë në shkelje te nenit 59 të LPP-së, kete konstatim dhe vleresim eshte bere edhe nga ESH si dhe nga PSH ne Vendimi i OSHP - PSH nr. 2025/0661; 2025/0660; 2025/0643; 2025/0657 i dates: 16.09.2025 – RIVLERESIM – duke shpallur te pa pergjegjshem GOE te rekomanduar per dhenie te kontrates nga AK – Komisioni RI-Vleresimit, qe dot e thote se AK nuk ka respektuar kriteret e përzgjedhjes – ANEKSIN 8 te FDT-se dhe Vendimin e OSHP- PSH si me lart te theksuar.

PROVË: Libreza e Qarkulimit e dorezuar nga GOE yne me targa: 01-529-NT dhe Libreza e qarkullimit nga GOE te rekomanduar per kontrate me me targa: 02-354-FL.

Provë: Raporti i ESH nr. 2025/0661 dhe Vendimi OSHP- PSH nr. 2025/0661

Pretendimi: nr. 2

Duhet cekur fakti se GOE i rekomanduar nga AK – Komisioni i RI-vlerësimit perveq qe nuk ka arrit te plotësoj kriteret e përzgjedhjes te percaktuar ne DT dhe NJK po ashtu eshte ne shkleje te nenit 4 te Udhezuesit nr. 001/2023 ku thote po citoj:

“Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

- a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive;
- b. për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe
- c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.”

Per faktin se GOE tek përshkrimi i cmimeve ne paramas dhe parallogarit ka dhene cmime shume te larta mbi tregu aktual, qe do te thote se AK – Komisioni i RI-vlerësimit nuk ka hulumtuar dhe analizuar fare cmimet e tregut si dhe nuk ka luajtuar rol aktive fare, por edhe perkunder qe nuk i ka plotesuar Kriteret e përzgjedhjes te cituar si me lart nga ana jone ne kete KpR, ka rekomanduar per Kontrate nje GOE i cili ka tenderuar me cmimet shume te larta dhe demtohet ne mas te madhe Buxheti i Komunes

AK – Komisionit te RI-vlerësimit, i cili fare nuk eshte marr me kete pjese duke shkelur nenin 4 te Rregullorese pasi qe pas qasje nen dokumente te tendeirit per kete AP kemi konstatuar se AK – komisioni i Ri-vleresimit me date 27.10.2025 ka kërkuar sqarime per cmime jo normalisht te uleta drejtuar GOE te rekamonduar per kontrate – plote 5 dite pasi ka pranuar pergjigjiet nga ana jone me date 23/10/2025 qe KONSTATOHET se AK ka shkelur nenin 7 te LPP-se - Trajtimin e

barbaret per faktin se vetem pas pergjigjies tonet e argumentuar dhe ne përputhje te plote me nenin 61 te LPP-se, AK – komisioni i Ri[1]vleresimit ka vazhadhduar te kërkoj sqarime edhe per GOE te rekomanduar per kontrate edhe perkunder se eshte i pa pergjegjshem administrativisht.

Pergjigjie per sqarime nga GOE i dhen me date 28.10.2025 eshte pranuar nga AK – Komisioni i vlerësimit se gjeja kinese eshte ne përputhje me nenin 61 te LPP-se, duke shkelur nenin 7 dhe 59 te LPP-se, duek na diskriminuar dhe duke e favorizuar GOE te rekomanduar per kontrate, per faktet si ne vijim:

Tabela e përshkrimit te çmimeve: Pozicionet tek paramasa dhe parallogaria Cmimet: Muhamet Muqici B.I.; Harst Group Shpk; Valdrini Shpk Cmimet nga GOE te rekomanduar per Kontrate N& N Shpk ; BM Group SHPK

Poz. nr. 1 5 0.1

Poz. nr. 2 0.1 1

Poz. nr. 3 66 182

Poz. nr. 4 18 30

Poz. nr. 5 43 50

1. Çmimet për pozicionin nr. 2 – ne sqarimet e dhene nga GOE te rekomanduar per kontrate jane plotësisht/teresisht jashte cdo rregulli per faktin se paramas dhe parallogarit eshte me poentim dhe sasia eshte m' – meter gjatesi dhe nuk dihen metrat gjatesi ndersa GOE ka filluar me paragjykime/parashikime 50 m' gje qe nuk eshte e sakt dhe eshte vetem GJASE, por jo e sakt?!.... dhe krejt ne fund te analizes i del se KOSTOJA totale ne euro per meter gjatesi –m' te jete 111.12 Euro/m' – gje qe eshte sakte ne kundërshtim me çmimin dhene vete ne paramas dhe parallogarit 1 euro per meter gjatesi (m') qe edhe vete GOE e konstaton se ka dhene cmime qe nuk perputhen me pergjigjien e dhene ne sqarimet e dates 28.10.2025. KREJT kjo aalize dhe konstatim qe deshmon se nuk perputhet me çmimin e dhene nga vet GOE – AK – komisioni i ri-vleresimit e pranon kete pergjigjie qe fare ska kuptim dhe dëshmohet se eshte ne kundërshtim me vete çmimin e dhene, ndersa pergjigjien tone qe kemi dhene me date 23.10.2025 AK – komisioni i ri-vleresimit nuk epranon ashtu sic kemi arsyetuar edhe m elarte ne kete KpR ku e arsyetojm se AK – komisioni i ri-vleresimit na ka dirkriminuar dhe eliminuar padrejtësisht ne kete AP sepse ne kemi tenderuar me cmime te tregut dhe kemi faktuar cdo cmime permes analizes se zbërthyer sipas nenit 61 te LPP-se, mirepo AK nuk e pranon dhe nuk e argumenton mos pranimin e Analizes tone, ndersa pergjigjien e GOE te rekomanduar per kontrate e pranon edhe pse shuem qarte vrehet dhekonstatohet se nuk duhet te pranohet sepse këtij GOE metra gjatesi – m' i kushton 111.12 Euro dhe jo 1 euro, ne jemi diskriminuar sa i perket cmimeve jo normalisht te uleta.

2. Çmimet për pozicionin nr. 3 – ne sqarimet e dhena nga GOE te rekomanduar per kontrate deshmon se ketu ka dhene Cmime SHUME T ELARTE MBI TREGUN – (pasi qe sipas llogaris se tije ka dale 50.38 EURO pothuajse afërsisht me analizen tone 45.37 Euro, ndersa ne kemi dhen cmime prej 66 euro ndersa GOE i rekomanduar per kontrate ka dhene cmime prej: 182 euro), krejt kjo eshte e pranushme per AK – komisionin e ri-vleresimit, ndersa sqarime/pergjigjiet tona nuk jane te pranushme kjo deshmon dhe argumenton se ne si GOE jemi diskriminuar ndersa GOE i rekomanduar per kontrate eshte favorizuar haptas, krejt kjo ne

shkelje te nenit 7, 59 dhe 60 te LPP-se.

3. Çmimet për pozicionin nr. 4 dhe 5 - ne sqarimet e dhena nga GOE te rekomanduar per kontrate deshmon se nuk a dhene asnjë zbërthim ashtu sic kerkon neni 41 i rregullores dhe neni 61 i LPP-se, por cuditrisht kjo eshte e pranushem nga AK – Komisioni i Ri-vleresimit, krejt kjo pa bere nje vleresim te drejt dhe sipas dispozitave ligjore te LPP-se, andaj kjo deshmon dhekonstaton se AK ke shkelur korinezn ligjore te LPP-se ne fuqi me rastin e refuzimit te ofertes tone per cmimet jo normalisht te uleta, duke na diskriminuar hapur dhe shkelur nenin 6, 7 dhe 59 te LPP-se.

- Provë - cmimet e dhene nga sqarimet/pergjigjiet tona per poz. 4 dhe 5 jane: 18 euro dhe 43 euro qe jane cmime te tregut ashtu sic i ka pranuar AK per GOE te rekomanduar per kontrate te cilat jane sikurse ne tabele me lart ne kete KpR. Andaj AK – komisioni i rivleresimit me rastin e mos pranimit te cmimeve te dhene ne pergjigjien e dates 23.10.2025 ka shkelur dispozitat e LPP-se duke na eliminuar padrejtësisht dhene shkelje te nenit 41 te Rregullores dhe neni 61 te LPP-se.

Prove: Procesverbali i hapjes, Pershkrimet e cmimeve dhe cmimet e tregu me prova konkrete te perezantuar nga ana jone me date 23.10.2025.

Duke marr per baze dokumentet e tenderit – DT dhe NJK, sqarimet dhe pergjigjiet e dhene nga ne me date 23.10.2025, si dhe pretendimet tona qe i shtjelluam dhe argumentuam ne kete Kerkese per Rishqyrtim, - Raportin e Ekspertit shqyrtues te dates 29.07.2025. Vendimin e OSHP – PSH nr. 2025/0661 te dates 16.09.2025, kerkojm nga AK – ZPP – Komisioni i ri-vleresimit qe te analizojne hulumtojn dhe te vijne ne përfundim duke marr per baze edhe respektimin e dispozitave ligjore te LPP-se, TE APROVOJN KpR DHE TE KTHEJN NE RIVLERESIM KETE AP - duke na rekomanduar per kontrate per faktin se tashem eshte dëshmuar dhe konstatuar se ne jemi GOE te pergjegjshem duke plotesuar ne ploteni kriteret eperzgjedhjes ne DT dhe NJK, duke dhene cmime te arsyeshme dhe ne perpuhje me cmimet e tregut – ku kemi rezliazur disa kontrata te natyres se njëjte pikerisht me Komunen e Prishtines, dhe per te cilat kemi referenca pozitive, andaj mbesim me shpresen se AK – ZPP do te vperoj neperputhje me dispozitat ligjore te LPP-se – Parimin e prokurimit – “vleren per para” dhe nese akoma kane dileme mund ta rrisin sigurimin e ekezekutimit sipas nenit 29.4 te Rregullores nr. 001/2022 per PP, dhe te na shpërblej me kontrate dhe mos te na detyroj pa deshiren tone dhe vullnetin tone ti drejtoheni institucioneve tjera relevante, por ta shqyrtojn edhe raportin e ESH dhe Vendimin e PSH dhe te nxjerrin përfundime dhe konstatime krejt ne përputhje me cdo dispozite ligjore te LPP-se, dhe te Aprovohet kerkesa per Rishqyrtim dhe te kthehet lenda ne rivlerësim duke na rekomanduar per kontrate, sepse jemi te pergjegjshem administrativisht, ne përputhje me cmimet e nenit 61 te LPP-se, dhe kemi tenderuar me çmimin me te ulete ne kete AP.

Ne mbesim me shpresen se AK – ZPP do te reflektojn dhe te shterrin te gjitha mundesit ligjore te cilat jane te parapar me dispozita ligjore te LPP-se, dhe te sigurohen dhe te konstatojn se NE si GOE jemi te pergjegjshem dhe plotesojm kushtet dhe kriteret e dhenies sipas dosjese se tenderit dhe njoftimit per kontrate. Nese nuk merren per baze ne detyrohemi pa vullnetin tone ti drejtohem institucioneve tjera relevante.

Pretendimi nr. 3

AK – ZPP ka Refuzuar KpR, mirepo nuk ka respektuar nenin 108/A te LPP-se par. 8 dhe 12 duke mos arsytuar dhe duke vazhduar me diskrimin dhe eliminimin duke vepruar ne shkelje te dispozitave ligjore te LPP-se

Mirëpo AK nuk shqyrton pretendimet tona fare vetëm arsyeton se ka respektuar LPP duke mos e trajtuar fare me çështjet e ngritura ne pretendimet tona ankimore dhe shqetësimet tona lidhur me ketër aktivitet te prokurimit edhe përkundër qe kemi argumentuar detajisht, DUKE OFRUAR PROFAVA DHE FAKTE KONKRET.

AK – ZPP ka nxjerr vendim ne kundërshtim ME NENIN 108/A te LPP-se si dhe ne kundërshtim me nenin 59 dhe 60 te LPP0-se krejt kjo Eshte bere me qellim te diskriminimit tone dhe elemnimit tone nga konkurrenca edhe perkunder se ne jemi tenderues i pergjegjshem me çmimin me te lire dhe brenda vleres se parashikuar nga AK ne dosje tenderit dhe duke pas parasysh pretendimet tona ankimore ne pamundësi per ti kundërshtuar me fakte dhe prova konkrete pasi PRETENDMET tona akimore kanë baze ligjore dhe qendrojn AK – ka zgjedhen formen e refuzimit te KpR pa u mbështet ne fakte dhe prova konkret dhe nuk eshte arsytuar ne asnje dispozit ligjore te LPP-së

Pra me fjale tjera AK ka refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim ne kundërshtim me nenit 108/A te LPP-se dhe per te mos komentuar dhe ne munges te provave dhe fakteve per shkeljet qe kane ndodhur ne vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave, AK është shume i vetëdijshtëm për shkeljen e dispozitave ligjore te LPP-se. Krejt kjo eshte Vendim mbi refuzime ne shkelje te dispozitave te LPP-se, per faktin se nuk eshte pergjigjur ashtu sic e obligon neni 108/A i LPP-se, por eshte thirrur gabimisht nenenin 4.1.26 te LPP-se, edhe perkunder se ne jemi pale me interes dhe jemi me çmimin me te ulet.

Me kete rast AK ka shkelur edhe nenin 97 te Rregullores nr. 001/2022 per PP – versioni konsoliduar, per faktin se NUK eshte respektuar vendimi i OSHP - vendimin me nr. 2025/0661 duke aprovuar ne teresi dhe ka kthyer Lenden ne Rivleresim me date 16.09.2025, per faktin se AK – Komisioni i rivleresimit ka nxjerr edhe fakte dhe arsytme tjera Jashte Vendimit te OSHP, sepse fakti kur nxjerret nje vendim i OSHP dhe aprovohet kerkes per rivleresim, AK – komisioni i rivleresimit duhet te sqaroje vetem piket per te cilat OSHP me Vendim ka obliguar AK te korigjoj dhe te RIVLERSOJ, por jo te kthej ne gjendje fillestare te rivleresimit. Ky fakt deshmon se Komuna e Prishtinese, ka vepruar ne kundërshtim te Vendimit te OSHP, sepse ka ngritur arsytme tjera te paqendrushme per eliminim, qe do te thote se Komisioni i dyte nuk ka qene profesional dhe ka nxjerr vendim krejt tjeter nga Komisioni i pare, gje qe NJERIKOMISON APO TE DY Komisionet e vleresimit kan shkelur RENDE dispozitat ligjore te LPP-se, dhe duhet te merren masa ndaj Komisioneve te vleresimit dhe ZPP, per faktin se shuem qarte neni 59.1 i LPP-se, thote se Komisioni i rivleresimit duht te jen profesional dhe rivleresimit te behet neperputhje mekritert e perzgjedhjes dhe te respektohet parimi kryesor i Prokurimit VLERA PER PARAN, dhe jo te nxjerrin raporte te vleresimit krejt te ndryshe dhe ne shkelje te LPP-se. Kerkojm nga PSH – OSHP te veproj ne perputhje me nenin 40.2.1 te Rregullores ne fuqi per PP dhe ta detyroj AK – te veproj ne perputhje me vendimin tashme te nxjerr nga OSHP - PSH. 40.2.1 Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një kërkesë të OE për rishqyrtim të vendimit të AK-së, AK e kthen lëndën në rivlerësim për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore. Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një vendimi të OSHP-së, rivlerësimi bëhet për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHP-së. Rivlerësimi i tenderëve mund të bëhet nga i njëjti komision, i cili ka kryer vlerësimin e tenderëve.

Gjithashtu, ritheksojme se edhe pas sqarimeve sipas nenit 61 te LPP-se dhe nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, ne perseri kemi dhen sqarime dhe ARGUMENTE BINDESE, se ne jemi ne perputhje te

plote me te gjitha kereesat teknike dhe profesione te nenit 9.1 & 9.2 te FDT-se, duke tenderuar me cmime te TREGUT dhe duke ofruar mundesin per AK te rris Sigurimin e Ekzekutimit sipas rregullores ne fajle dhe po ashtu kemiplotesuar nenin 30.1 te FDT-se.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me nenin 6, 7, 59 te LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesorë për dhënie te kontratës, e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe nenin 1 te LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosoves.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE “Muhamet Muçiqi” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Neni 1 të LPP-së 2. Neni 2 të LPP-së 3. Neni 6 të LPP-së 4. Neni 7 të LPP-së 5. Neni 24 te LPP-së 6. Neni 51 te LPP-së 7. Neni 52 par. 7 të LPP-së. 8. Neni 56 të LPP-së. 9. Neni 55 i LPP-së 10. Neni 59 par. 1, 2 dhe 4 të LPP-së 11. Neni 60 par. 1.1 te LPP-së. 12. Neni 61 i LPP-së 13. Neni 72 i LPP-së 14. Neni 29.1 dhe 29.4 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP 15. Neni 30.4 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP 16. Neni 40.6 dhe 40.7 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP 17. Neni 41 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP 18. Neni 41.9 dhe 41.10 par. b të Rreg. Nr. 001/2022 per PP 19. Neni 40.3 40.6; 40.7 dhe 40.8 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP 20. Neni 44.3 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP 21. Neni 45.22 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP 22. Neni 45.26 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP 23. Neni 4 i Udhëzuesit Nr. 002/2023 për PP. Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga ESH dhe PSH qe te merr: V E N D I M APROVOHET, - si te bazuar Kerkesen per Rishqyrtim nga GOE: Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini sh.p.k, LLAPASHTICË E EPËRME, 11000, , Kosovë ANULOHET, - njoftimi mbi vendimin e AK-se për dhënie te kontrates dhe lënda te kthehet ne RIVLERESIM, - Autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te bëhet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave te LPP-së.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “Muhamet Muçiqi: Operatori ekonomik "Muhamet Muçiqi B.I." (tutje "parashtruesi") me datë 17.11.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit sikurse janë formuluar në kërkesën për rishqyrtim, manifestohen ashtu që ktmërshtohen të gjitha arsyet për eliminimin e parashtruesit nga aktiviteti i prokurimit si dhe pretendohet që tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të

papërgjegjshme për arsyet e cekura në kërkesën e tij për rishqyrtim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

Teaderi jnaj është refuzuar për kete arsye: prezantuar në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “VIA EGNATIA” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

1. AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së pasi që gjatë procesit të ri vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk kanë luajtur aspak rol aktiv për t’u siguruar se fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe transparente. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kriterëve të parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa asnjë të drejtë na ka eliminuar nga konkurrenca edhe pse kemi dorëzuar dëshmi të mjaftueshme që tregojnë se kemi realizuar projekte të natyrës së njëjtë në të kaluarën. Mos aplikimi si duhet i kërkesave të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, mos aplikimi edhe i nenit 59 dhe 72 të LPP-së si dhe mos respektimi i kërkesave që dalin nga Vendimi i OSHP-së, e shtynë AK-në jo vetëm drejt shkeljes së nenit 1 të LPP[1]së por edhe drejt shkeljeve tjera sepse me këtë veprim po tenton që në kundërshtim me realitetin dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, të shpallë prap fitues një tenderues tjetër të papërgjegjshëm.

Në këtë tender shihet qartë se ne jemi tenderues i përgjegjshëm dhe kemi çmimin më të ulët në krahasim me tenderuesit e përgjegjshëm andaj shpërblimi jonë me kontratë është detyrim ligjor që do të ndikonte pozitivisht në shfrytëzim të mjeteve në mënyrë më efikase, më efektive dhe më drejtë të mundshme, ashtu siç e kërkon nenin 1 i LPP-së.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së duke mos vlerësuar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e neneve tjera që do të i potencojmë në vazhdim.

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë ri vlerësimit të tenderëve nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. Kjo ka ardhur si pasojë e asaj kur AK na ka konsideruar të përgjegjshëm duke na eliminuar nga konkurrenca edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht të dosjes së tenderit që ishin përcaktuara paraprakisht nga vet AK-ja.

Me vet faktin që edhe OSHP e ka konstatuar se ne e plotësojmë kriterin lidhur me kontratat e realizuara në të kaluarën nga natyra e ngjashme, tregon për jo ligjshmërinë dhe për jo seriozitetin e AK-së. Nga arsyetimi për eliminim që na ka dërguar AK dhe pas krahasimit të tij me kërkesat e dosjes së tenderit, shihet se ne jemi tenderues komplet i përgjegjshëm dhe se AK gjatë ri vlerësimit të tenderëve ka kërkuar sqarime shitesë për diçka që tashmë veç është sqaruar nga OSHP-ja. Pra, pavarësisht kontratës në fjalë, ne e arrijmë kriterin e kërkuar për referencat, mjaftueshëm edhe vetëm me kontratat tjera të projekteve të realizuara që ne kemi paraqitur në tender dhe se kontrata që AK ngul këmbë ta sqarojë nuk është fare relevante.

Përpos tjerash, shihet se AK ka aplikuar ligjin në mënyrë të gabuar kur na ka eliminuar për referenca të kompanisë pasi që në kundërshtim të plotë me nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së ka aplikuar pa nevojë procedurën e sqarimit të tenderëve edhe pse vlera e tillë e kërkuar e referencave është arritur pa pasur nevojë për kontratën që AK insiston ta sqarojë.

Nisur nga krejt kjo, po shihet hapur se tentimi për sqarim të një kontrate e cila nuk është relevante pasi që kriteri është plotësuar mjaftueshëm me kontrata tjera, e shtynë AK-në drejt diskriminimit të plotë ndaj tenderit tonë. Shto këtu faktin që ne jemi tenderues me çmim më të ulët në krahasim me tenderuesit e përgjegjshëm e që tregon se AK ka shkelur edhe nenin 1 si dhe 60 të LPP-së duke mos shfrytëzuar aspak buxhetin e vet në mënyrë efikase dhe të drejtë.

Sipas asaj që e thotë neni 7 i LPP-së, kjo konsiderohet trajtim jo i barabartë i tenderuesve përkatësisht favorizim i plotë GOE të shpallur fitues dhe diskriminim i pastërt ndaj neve e që njëherit konsiderohet shkelje e plotë e kësaj dispozite ligjore. Më detalisht për secilin gabim të AK-së që ka bërë gjatë këtij procesi të vlerësimit si dhe për çdo mangësi të OE të shpallur fitues, do ju njohim në pretendimet në vazhdim.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RRPP-001/2022 pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka respektuar kërkesat dhe kriteret e veta nga dosja e tenderit si nuk i ka respektuar as dispozitat ligjore për sqarim të tenderëve duke aplikuar arsye të pa qëndrueshme me rastin e eliminimit tonë nga konkurrenca.

Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

E paraqesim këtë sepse ashtu siç e sqaruam edhe tek pretendimi i kaluar shihet se AK na ka eliminuar neve për kriteret dhe kërkesa që faktikisht janë plotësuar dhe se nuk është dashur të kërkoj fare sqarime për kontratën që insiston me ngulm ta bëjë. Kërkesat e dosjes së tenderit tek procedura e hapur me kriter vlerësimi – çmimi më i ulët me poentim janë kërkesa kalon/nuk kalon që do të thotë se posa të arrihet plotësimi i kriterit apo të arrihet vlera e kërkuar e referencave, kushti konsiderohet i pranuar. Ne e kemi arritur këtë kusht pa pasur nevojë për kontratën që AK ka kërkuar sqarime andaj duke u mbështetur edhe në konstatimin e OSHP-së kemi konsideruar me arsye të qëndrueshme se nuk kemi nevojë të japim sqarime pasi që kjo kontratë është jo relevante në rastin konkret.

Për ta sqaruar edhe më mirë këtë, në vazhdim po e paraqesim se si duket arsyeja e eliminimit të tenderit tonë duket kështu:

Ky arsyetim nuk qëndron fare sepse ne kemi dorëzuar listën e kontratave nga ku shihet qartë se si Grup i OE në të kaluarën e kemi realizuar kontrata të ngjashme në vlerë të mjaftueshme për ta plotësuar kërkesën e AK-së. Para se të argumentojmë plotësimin e këtij kushti, duam të pasqyrojmë formën se si ishte vendosur kërkesa në dosje të tenderit.

Nisur nga forma e kërkesës së parashtruar nga vet AK, dhe krahasuar me listën e kontratave të realizuara nga ne në tre vitet e shkuara që e gjeni të bashkëngjitur, shihet se arrihet mjaftueshëm vlera e kërkuar projekteve të realizuara në kontrata të ngjashme edhe pa kontratën “Vendosja e gardhit mbrojtës të lumit Shkumbin”. Pavarësisht kësaj AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë lidhur me paqartësitë që shihet se i ka pasur sidomos lidhur me natyrën e kontratave tjera që ne i kemi realizuar dhe paraqitur si Grup i OE, andaj me të drejtë konstatohet se AK ka shkelur nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së kur ka kërkuar sqarime @ vetëm për kontratën “Vendosja e gardhit mbrojtës të lumit Shkumbin” e cila në këtë rast është jo relevante. Përpos kësaj, me rastin e mos kërkit të sqarimeve nga ne për kontratat tjera, AK ka shkelur edhe nenin 38 dhe 40 të RRPP-001/2022 si dhe nenin 10.1 të UOP[1]001/2023. Përpos krejt kësaj, lehtë konstatohet se AK ka shkelur edhe interpretimin e KRPP-së lidhur me konsiderimin apo jo si të pranueshme të kontratave të ngjashme

Në këto dispozita dhe nga ky interpretim, shumë qartë tregohet se kur AK e ka të paqartë ndonjë dëshmi ose kur mungon ajo apo është dorëzuar ndonjë dokument i gabuar, ose edhe kur mungon referenca nga lista e kontratave të prezantuara, AK duhet të kërkoj sqarime shtesë nga OE. Këtë veprim nuk e ka bërë AK por përkundrazi e ka keqpërdorur si mundësi andaj me të drejtë konstatojmë se gjatë procesit të vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve, AK ka shkelur plotësisht neni 59 të LPP-së, nenin 38 dhe 49 të RRPP-001/2022 si dhe ka shkelur nenin 10.1 UOP-001/2023. Sipas njoftimit mbi vendimin e AK dhe arsyeve të eliminimit tonë, shihet se AK nuk i ka pranuar asnjë nga kontrata/referencat tjera dhe se për këtë nuk ka dhënë asnjë sqarim se pse nuk i ka pranuar. Ne konsiderojmë se kriteri i kërkuar për referencat është plotësuar mjaftueshëm me kontratat tjera sidomos kur merret për bazë interpretimi i KRPP-së, gjë të cilën e ka konstatuar edhe OSHP në Vendimin 2025/0643 andaj veprimi i AK-së për eliminimin tonë konsiderohet plotësisht i pa bazuar dhe i jashtëligjshëm.

Përpos kësaj, lidhur me vlerësimin AK-së e vlen të thuhet edhe kjo se disa GOE që kishin çmimin më të ulët se tenderi jonë janë cilësuar si të papërgjegjshëm nga AK por njëri nga ta edhe pse nuk ishte i përgjegjshëm është shpallur pa asnjë të drejt si fitues. Pas analizimit të tenderëve të tyre vërehet gjendja e mos plotësueshmërisë së kërkesave nga dosja e tenderit apo më mirë të themi vërehen mangësitë e tyre përpos asaj që ka thënë AK, ku përfshihet edhe OE

që tashmë AK e ka shpallur si fitues. Ja si duken mangësitë e tyre: Grupi i OE “Muhamet Muçiqi; HARST Group; SH.P.K.; Valdrini sh.p.k.” - Anëtari Eco Clean(Muhamet Muçiqi B.I.) nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhe me kërkesat e kontratave të ngjashme

- Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132(vetëm dud)

- Ka dorëzuar CV për teknikun që nuk përmban informatat e nevojshme dhe të pa-nënshkruar nga personi që i përket

Grupi i OE “AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha”;

- Anëtari Multi Business Group SH.P.K. - Raporti i vlerësimit të riskut e ka por mungon licenca e Kompanisë së licencuar për ushtrimin e aktivitetit të punës profesionale nga siguria dhe shëndeti në punë;

- Tek të gjitha Marrëveshje u mungon emërtimi i pajisjeve (nuk janë të cekura pajisjet sipas emërimit);

- Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132;

- Mungon marrëveshja me NTSH Gjyli Komerc;

Përpos kësaj edhe vet GOE i shpallur fitues edhe pse e ka çmimin më të ulët se ne, ka mangësi në tenderin e tyre që e bëjnë atë tender të papërgjegjshëm. Ja si duken mangësitë e tilla:

Grupi i OE “N & B SH.P.K.; BM Group SH.P.K.”:

- Nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me kërkesën për kontratat e ngjashme;

Kontratat e tilla nuk është dashur të pranohen sidomos kur krahasohen me kontratat tona dhe kur merret parasysh që kontratat tona (që AK i ka refuzuar) janë shumë më të përafërta me natyrën e projektit se sa këto që ka dorëzuar ky GOE.

- Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132(vetëm dud), Vet kërkesa e AK ka qenë që për automjetet që regjistrohen duhet të dorëzohet libreza e regjistrimit. Ky GOE nuk i ka paraqitur Damperat me libreza prandaj konsiderojmë se është i papërgjegjshëm. Në këtë rast AK ka shkelur kërkesën e dosjes së tenderit, ka shkelur nenin 59 të LPP-së si dhe ka shkelur edhe Ligjit 05/L-132 për Automjete i cili obligon regjistrimin e secilës pajisje që lëvizë në rrugë me goma dhe ka peshë më shumë se 700KG.

Sipas krejt kësaj, po shihet se tenderi jonë është tenderi që realisht është me çmim më të ulët nga të gjithë tenderët e përgjegjshëm dhe se i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e dosjes së tenderit për tu shpërblyer me kontratë.

Pra nga kjo po shihet se mos veprimi i AK-së gjatë procesit të ri vlerësimit sipas detyrimeve ligjore dhe mos veprimi edhe sipas kërkesës së Vendimit të OSHP-së, përkatësisht mos sqarimi i tenderit tonë si duhet si dhe mos respektimi edhe i Ligjit për Automjete përkatësisht Ligjit me nr. 05/L-132, e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 59 të LPP-së dhe drejt mos respektimit të Vendimit të OSHP-së.

4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar dispozitat në të cilat thuhet se OE/GOE përkatësisht tenderët duhet që së pari të jenë të përgjegjshëm për nga plotësueshmëria

e kërkesave të dosjes së tenderit, e më pas të vlerësohen në renditje sipas çmimit më të ulët. Në rastin tonë AK është dashur të na shpallte neve si fitues sepse i plotësojmë të gjitha kriteret e nevojshme për tu cilësuar si tenderues i përgjegjshëm dhe se posedojmë çmimin të ulët në krahasim me të gjithë tenderuesit e përgjegjshëm. Tenderuesi i shpallur fitues posedon çmimin më të ulët por është i papërgjegjshëm andaj kjo tregon se AK nuk ka respektuar kriterin e vlerësimit. Mos respektimi i këtij kushti nga ana e AK-së e shtynë atë drejt shkeljes së plotë të nenit 60 të LPP-së.

5. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së, nenin 38 të RRPP-001/2022 dhe nenin 10.1 të UOP-001/2023 pasi që nuk i ka respektuar fare detyrimet ligjore dhe këshilluese që dalin nga dispozitat e tilla. Këto dispozita janë shkelur për faktin që AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga ne lidhur me natyrën e të gjitha kontratave të prezantuara në listën e projekteve të realizuara por ka kërkuar vetëm për një nga to, edhe pse shihet se ka pasur paqartësi të madhe në këtë drejtim. Mos respektimi i dëshmive kualifikuese të tenderit tonë dhe refuzimi i tijë pa kërkuar asnjë sqarim apo plotësim ligjor për të gjitha kontratat por edhe duke mos dhënë fare arsye pse nuk ka pranuar si të rregullta kontratat tjera, e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 72 të LPP-së, nenit 38 të RRPP-001/2022 dhe nenit 10.1 të UOP-001/2023.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi "VIA EGNATIA" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RRPP-001/2022, AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së, nenin 38 të RRPP-001/2022 dhe nenin 10.1 të UOP-001/2023, Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdesë ankesën dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë: V E N D I M APROVOHET si e bazuar ankesa e Grupi i OE "VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SHPK Dega në Kosovë" lidhur me tenderin "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" i iniciuar dhe administruar nga KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINES. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINES dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që fitues të shpallej Grupi i OE "VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SHPK Dega në Kosovë"

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE "VIA EGNATIA" SH.P.K Operatori ekonomik "Via Egnatia shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 17.11.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër ndjftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtresit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtresit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtresit sikurse janë formuluar në kërkesën për rishqyrtim, manifestohen ashtu që kundërshtohen të gjitha arsyet për eliminimin e parashtresit nga aktiviteti i prokurimit. Po ashtu ka prezantuar edhe disa pretendime kundër OE të tjerë sikurse në kërkesën e tij për rishqyrtim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtresë është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Teaderi juaj esh të retanar per këto arsye:

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme.

Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesit e tjerë është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Përndryshe oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AGRO INVEST 1” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Rrjedha e procedurës:

Grupi i Operatorëve Ekonomik AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K., më datë 18.04.2025 kemi dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës ofertën për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”, me numër të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, dhe në po të njëjtën datë AK ka publikuar Procesverbalin e Hapjes së tenderit, sipas të cilit GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K. kemi qenë OE i dytë me çmimin më të lirë, përkatësisht me çmim të ofertës (të peshuar) 79,93 euro.

Nëpërmjet Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 30.06.2025 ne si GOE jemi eliminuar nga AK mbi këto arsye:

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së 30.06.2025

Pasi që AK kishte refuzuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim, ne i jemi drejtuar OSHP-së me ankesë dhe nëpërmjet Vendimit OSHP: 2025/0657 të datës 16.09.2025, OSHP kishte aprovuar ankesën tonë, lëndën e kishte kthyer në RIVLERËSIM dhe në të njëjtën kohë ky Vendim i OSHP-së kishte konfirmuar se OE më i lirë në garë: “Muhamet Muçiqi & HARST Group SH.P.K & Valdrini SH.P.K.” ishte administrativisht i papërgjegjshëm.

Në këto rrethana GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K. ishim OE më i lirë i përgjegjshëm i mbetur në garë. Gjatë rivlerësimit, AK më 20.10.2025 nëpërmjet Formularit B41- Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët

jo-normalisht të ulët ka kërkuar nga ne si GOE sqarime për çmimet në disa pozicione. Ne më 21.10.2025 AK-së i kemi ofruar të dhëna të detajuara si kemi ardhur deri tek çmimi i vendosur në paramasë, duke treguar qartë se si kemi ardhur në ato çmime, si të njëjtat janë të varura nga disa faktorë për të cilat kemi ofruar fakte dhe prova të qarta.

AK më 11.11.2025 publikon Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, ndërsa neve na eliminon me arsyetime tërësisht tjera në krahasim me eliminimin paraprak, konkretisht oferta jonë refuzohet mbi këto arsye:

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 11.11.2025

Kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 11.11.2025, ne më 14.11.2025 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, ndërsa të njëjtën AK më 19.11.2025 e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar.

GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K. nuk pajtohet aspak me këtë vendim, i njëjti është i kundërligjshëm sepse ne jemi OE plotësisht i përgjegjshëm dhe kemi çmimin më të lirë në mesin e operatorëve të përgjegjshëm.

Në vazhdim gjeni pretendimet ankimore të GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K.

Pretendimi 1: AK në kundërshtim me Ligjin nuk është përgjigjur në pretendimet tona të paraqitura nëpërmjet Kërkesës për Rishqyrtim GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K. më 14.11.2025 ashtu siç u potencua edhe më lartë kemi parashtruar pranë AK-së Kërkesë për Rishqyrtim. Nëpërmjet kësaj kërkesë ne kemi ngritur pretendimet tona ankimore duke argumentuar në mënyrë shterruese se pse vendimi për eliminimin e ofertës tonë është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit duke ofruar edhe prova mbështetëse.

Gjatë analizimit të Vendimit për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim vërejmë me shqetësim se arsyetimi i dhënë nga AK është tepër i përgjithshëm dhe i paargumentuar me fakte apo prova konkrete. Gjithashtu, përmbajtja e përgjigjes lë të kuptohet se ajo nuk është përgatitur me kujdes profesional dhe trajtim të drejtpërdrejtë të çështjes nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit.

Konstatimet e paraqitura në të gjitha pikat e vendimit të AK-së janë të mangëta dhe si të tilla nuk janë të bazuara dhe argumentuara me faktet vendimtare në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara nga ne, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dispozitave ligjore të LPP-së. Nga ky vendim shihet qartë se AK i ka trajtuar shkarazi dhe në mënyrë selektive pretendimet dhe argumentet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, ashtu që duke u shmangur detyrimeve ligjore dhe duke i anashkaluar faktet vendimtare dhe rrethanave të rastit konkret ka paraqitur pasqyrim të gabuar të gjendjes faktike që nuk përkon me realitetin, rrjedhimisht që e ngatërron gjendjen e saktë faktike dhe përshkrimin ligjor në mënyrë që të na mohoj të drejtën në rivlerësim të drejtë të procesit, me qëllim që të jepet përshtypja se asgjë e paligjshme nuk ka ndodhur

Prandaj, ky arsyetim i vendimit të atakuar nuk e ka vërtetuar saktë dhe drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta e dispozitave materiale të LPP[1]së (Neni 108/A) përfshirë edhe keqinterpretimi i tyre dhe kërkesave të dosjes së tenderit.

Sepse arsyet e dhëna në vendimin e AK-së nuk janë të bazuar në LPP dhe legjislacionin dytësor të prokurimit publik.

AK në vend që tu përgjigjej pretendimeve tona ankimore, e njëjta vetëm potencon se arsyet e eliminimit janë të sakta të matshme dhe të ligjshme. Duke mos dhënë ASNJË shpjgim se si arsyet për eliminim janë të sakta kur ne si OE kemi parashtruar dhjetra argumente të cilat e dëshmojnë të kundërtën. Për më tepër shih arsyetimin e AK-së lidhur e Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim:

Vendimi i AK-së i pa arsyetuar, respektivisht pa i trajtuar pretendimet ankimore të GOE

AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K., shkelë në mënyrë flagrante Nenin 62, par. 2 të RrPP-së, i cili nen kërkon taksativisht se: “Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit”. Përveç kësaj, Vendimi i AK-së bije ndesh edhe me Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku në nenin 48, paragrafi 1, nënparagrafi 5, taksativisht thekson se: “1 Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: (1.5.) “shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve”.

Pretendimet e GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K. nuk janë trajtuar në mënyrë serioze nga AK. Andaj, bazuar edhe në nenin 48, par. 2 të po të njëjtit Ligj: “Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Prandaj një akt i tillë duhet të ANULOHEJ nga OSHP.

Pretendimi 2: AK me FDT nuk ka kërkuar që ofertuesit të bashkëngjisin specifikime teknike

Autoriteti kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit në FDT NUK ka kërkuar që operatorët ofertues të bashkëngjisin ndonjë specifikim, dokument, apo dëshmi të caktuar. Konkretisht në FDT nuk përmendet asnjë kërkesë e tillë lidhur me specifikimin teknik, ndërsa në Aneks 1 thuhet se: “Sipas përshkrimit teknik - Paramases dhe skicave të projektit të bashkëngjitura në DT”.

Pra, AK në asnjë formë nuk ka kërkuar, apo nuk ka lënë të kuptohet se ne si GOE në këtë rast është dashur të dorëzojmë specifikime teknike. Pra në rastin e aplikimit në normalisht se jemi pajtuar që të zbatojmë specifikimet e autoritetit kontraktues, mirëpo meqë nuk është kërkuar me FDT ne nuk kemi bashkëngjit diçka tjetër, prandaj është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së që ne të eliminohejmë për diçka që AK nuk ka kërkuar me FDT. Ne me dorëzimin e ofertës normalisht se jemi pajtuar që kontratën ta zbatojmë sipas specifikave të AK-së, mirëpo ne nuk hartojmë specifika teknike, specifikat i harton AK, ndërsa nga ne ka mundur të kërkohej ndonjë katalog, deklaratë apo diçka e ngjashme, mirëpo këtë AK me FDT nuk e ka kërkuar në asnjë formë.

Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim 19.11.2025

Ne kemi hulumtuar disa aktivitete të ngjashme ku AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka kërkuar me FDT bashkëngjitjen e dëshmimeve lidhur me specifikimet teknike, ku në këto rrethana ofrimi i dëshmimeve do të përbënte kusht për përgjegjshmërinë e ofertuesve. Rastet e tilla po i bashkëngjisim në vazhdim:

Aktiviteti i prokurimit “Ndërtimi I rrethojave për siguri ne komunikacion”, me numër: 616-25-1891-5-1-1 Aktiviteti i prokurimit: "Ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet", me numër: 616-23-4190-5-1-1 Aktiviteti i prokurimit: "Ndërtimi i rrethojave dhe ndriqimi i fushës së futbollit të Klubit të Futbollit Prishtina - Bërnice" me numër:616-13271-5-5-1

Prandaj, AK po të kishte një kërkesë që OE-të ofertues të dëshmojnë përmbushjen e specifikave teknike me dëshmi përkatëse, atëherë ne si GOE do e bënim, mirëpo në këto rrethana shihet qartë se kjo arsye e eliminimit tonë është në kundërshtim e LPP-në, sepse arsyeja e eliminimit është lidhur me diçka që nuk ka kërkuar AK.

Bazuar në nenin 40.12 të RrPP-së në mënyrë taksative potencohet se: “Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”. Gjithashtu bazuar në nenin 40.13 të RrPP-së potencohet se: “Komisioni vlerësues do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”.

Përtej kësaj ne kemi nënshkruar paramasën ku secili pozicion është në detaje i specifikuar sipas kërkesave specifike të AK-së. Prandaj, AK në kundërshtim me dispozitat ligjore na ka eliminuar mbi bazën se ne nuk kemi dorëzuar specifikimet teknike.

Pretendimi 3: GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K. nuk ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta

AK më 20.10.2025 nëpërmjet Formularit B41- Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët ka kërkuar nga ne si GOE sqarime për çmimet, konkretisht:

Ne si GOE më 21.10.2025 AK-së i kemi ofruar të dhëna të detajuara si kemi ardhur deri tek çmimi i vendosur në paramasë, ndërsa sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 11.11.2025, rezulton se AK nuk është pajtuar me shpjegimet lidhur me pozicionet 1, 3, 4 dhe 5.

Bazuar në nenin 61.2 të LPP-së, lidhur me nenin 41, paragrafi 8 të RrPP-së, Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

a). ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktivitetëve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Ne nëpërmjet përgjigjes së datës 21.10.2025 në mënyrë të detajuar e kemi shtjelluar secilin pozicion të kontestuar nga AK, konkretisht kemi ofruar këtë arsyetim:

ARSYETIMI I POZICIONIT 1

Piketimi i parcelave ku do të vendoset rrethoja- 0.50 €/cope

Matjet gjeodezike për këtë projekt do të behën nga gjeldeti ynë Agron Shabani me te cilin kemi bërë marrëveshje vjetore për bashkëpunim pavarësisht çfarëdo projekti që ka kompania, ndërsa pajisjet për matje gjeodezike janë në pronësi të firmës Agro Invest 1 Sh.P.K.

Gjeodeti deklaron me shkrim që është i gatshëm në çdo moment që ka nevojë kompania për matje gjeodezike, të del në terren dhe të kryej matjet sipas kërkesave të kompanisë.

Sqarimet e kërkuara nga AK me B41 të datës 20.10.2025 ku kemi bashkëngjitur edhe deklaratën e gjeodetit z. Agron Shabani.

ARSYETIMI I POZICIONIT 2

Demolimi dhe largimi i rrethojës ekzistuese, transport dhe deponim - 15.50 €/ Këtë çmim e kemi ofruar për këto arsye:

1) Kompania jonë ka makineri për prishje, demolim dhe transport të rrethojave, dmth nuk ka nevojë për marrje me qira, gjithashtu deponia për hekurishte është brenda në qytet (te rrethi i Ismetit) dhe kostoja për transport të rrethojave, për metër gjatësi është 3.80 euro .

2) Rrethojat për tu prishur janë kryesisht nga materiale të lehta dhe e njëjta deponohet në deponinë e hekurishteve që gjendet në brendësi të qytetit me çmimin e cekur më lartë -3.80 euro .

3) Ne po ashtu kemi leje me Kompaninë për menaxhimin e mbeturinave- KMDK në rast të pastrimit të vendit nga mbeturinat inerte, e cila edhe gjendet afër lokacionit të punimeve, që redukton kostot e transportit dhe deponimit sepse pllaci i jonë i makinerive gjendet në lokacionin e quajtur Bardhosh i cili gjendet larg qytetit vetëm 3 km dhe për atë arsye kostoja e kësaj pune për kompaninë tonë është tejet minimale. Çmimi për këtë pozicion është llogaritur duke përfshirë makinerinë, karburantin, stafin, transportin dhe deponimin.

Kostoja për demolimin dhe largimin e rrethojës ekzistuese duke përfshirë transportin dhe pagesën në deponi neve na del me 8.70 €/m'

Ku kemi bashkëngjitur kontratën e bashkëpunimit me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive:

ARSYETIMI I POZICIONIT 3

Furnizimi, punimi dhe montimi i rrethojës sipas detajeve teknike - 75.00 €/m'

1. Kompania jonë furnizohet nga prodhues vendorë të elementeve të kërkuara.

2. Elementet e rrethojës përpunohen në punishte tona, nga stafi ynë, pa kosto shtesë po ashtu montimi është planifikuar të kryhet nga ekipet tona

Në vazhdim po ua paraqesim llogaritjen për furnizim, punim dhe montim të rrethojës për një meter.

Llogaritja për 1 m' :

Cmimi për 1 m profil 60 x 60 x 3 mm : 8 m x 2.5 euro = 20 euro / m

Cmimi për 1 m profil 40 x 40 x 3 mm: 4 m x 1.6 = 6.4 euro / m'

Cmimi per 1 m profili 20 x 20 x 3 mm: 16 shufra x 1.4 m = 22.40 m x 0.60 euro = 13.44 euro / m' Germimi dhe betonimi: 6 €/

Punimi & lyerje dhe montim: 9.00 €/m

Totali: 54.80 €/ m'

ARSYETIMI I POZICIONIT 4 dhe 5

4- Furnizimi dhe montimi i derës për këmbësorë- 10.00 €/copë

5- Furnizimi dhe montimi i derës për automjete- 10.00 €/copë

Ne kemi ofruar çmimin prej 10 eurove për montimin e një dore për këmbësorë /automjete pasi që e kemi një sasi të konsiderueshme të profilave të mbetura në stok prej projektit “Ndërtimi i strehimores – parku i qenëve- Negociuar”, me numër të prokurimit 616- 24-8792-5-2-5, kontratë e nënshkruar pikërisht me AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës, e cila është përfunduar para 4 muajve dhe na duhet detyrimit me i vendos në punë diku për shkak se prishen nga korozioni.

Së bashku me shpjegimin kemi ofruar edhe disa fotografi të profileve të konsiderueshme të mbetura të pashfrytëzuara në stoqe të kompanisë tonë. Këto profile janë pikërisht material i duhur për rregullimin e dyerve të kërkuara në paramasë ndërsa në këtë çmim është llogaritur vetëm puna e dorës dhe ngjyrosja e dyerve.

PROVË: Shih përgjigjen e datës 21.10.2025.

AK në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 11.11.2025, vetëm potencon se kinse në si GOE nuk kemi ofruar arsye bindëse për AK-në lidhur me çmimet, por pa specifikuar konkretisht dhe në mënyrë shteruese atë se pse këto arsye nuk ishin bindëse, ose pse faktet dhe provat e ofruara për AK-në nuk ishin të mjaftueshme apo nuk ishin relevante. Kjo qasje Vendimin e bënë arbitrar dhe në kundërshtim me nenin 54 të LPP-së.

Të gjitha këto sqarime tregojnë qartë se çmimi i llogaritur dhe i ofertuar nga GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K ka qenë i ndikuar nga

ekonomiciteti i prodhimit, përkatësisht sigurimit të shërbimeve, zgjidhjet teknike të ofruara kushtet e favorshme që i kemi si GOE lidhur me stafin e angazhuar, posedimin e materialeve/profileve në stoqe, makinerisë dhe logjistikës që posedojmë dhe për të cilat kemi kosto minimale ashtu siç e kemi shpjeguar. Si dhe kemi argumentuar qartë se asnjë pozicion për të cilat AK ka kërkuar sqarim nuk do të përmbushet pa fitim, por për secilin nga to kemi marzhë fitimi. Prandaj, AK ka dështuar të zbatojë nenin 41.8 të RrPP-së, duke na eliminuar padrejtësisht nga ky aktivitet i prokurimit

Përveç se AK nuk ka arritur të zbatojë nenin 41.8. të RrPP-së, në të njëjtën kohë nuk ka arritur të zbatojë edhe nenin 29, paragrafi 4 të RrPP-së i cili taksativisht potencon se: “Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës, ndërsa të kontrata me çmim për njësi apo me poentim kërkohet 10% e vlerës së parashikuar. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, AK do të sigurojë që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shpëputet kontrata. Autoriteti kontraktues, pasi që të jetë

përputhur me nenin 61 të LPP-se, ka mjaft arsye për të besuar se Operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht të ulet), gëzon të drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit të ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata”.

Ne si GOE kemi dhënë sqarimet e plota dhe të detajuara duke bashkëngjitur edhe prova përkatëse me çka janë plotësuar të gjitha kërkesat dhe kushtet sipas nenit 61 të LPP-së, prandaj nëse AK edhe më tej ka dyshime se ne nuk mund të përmbushim pozicionet me çmimet që kemi ofruar, atëherë ne jemi të gatshëm që siguria e ekzekutimit të rritet sipas kërkesës së AK-së, vetëm për të siguruar AK-në se ne si GOE jemi të gatshëm të përmbushim në plotni kontratën.

Në GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K për të bindur AK-në se jemi të gatshëm ta përmbushim këtë kontratë me çmimet që i kemi ofruar, më 13.11.2025 kemi nënshkruar DEKLARATË ku bashkërisht shprehim vullnetin dhe gatishmërinë dhe jemi të gatshëm që para nënshkrimit të kontratës të dorëzojmë sigurinë e ekzekutimit të kontratës në çfarëdo vlere që e kërkon autoriteti kontraktues, për tu siguruar se ne do të përmbushim kontratën sipas çmimeve të dhëna dhe AK nuk do të pësoj dëm.

PROVË: Deklarata e datës 13.11.2025 të cilën po e bashkëngjisim në vazhdim.

Ne këtë deklaratë e kemi bashkëngjitur së bashku me Kërkesë për Rishqyrtim, mirëpo AK nuk e ka trajtuar dhe e ka injoruar në tërësi.

GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K është i bindur se ka dorëzuar tender të përgjegjshëm sepse tenderi ynë i përmbush të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues, dhe është në pajtim me LPP dhe e përmbush në tërësi nenin 40.6 të RrPP-së, ku shprehimisht thuhet se:

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;
- c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Përfundimisht Komisioni i vlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 59.1 të LPP-së dhe Nenit 40.1 të RRPP-së pasi të njëjtit janë të obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit, gjithnjë sipas Nenit 40.12 dhe 40.13 të RrPP-së. AK-ja nuk e ka respektuar edhe Nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT[1]së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik ne mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe Nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Prandaj, faktet dhe rrethanat e lartcekura e vërtetojnë se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm, sepse gjatë procedurës së vlerësimit është vendosur në dëm të tenderit/ofertës së OE ankues duke na mohuar të drejtën e ligjshme të shpërblimit me kontratë, pavarësisht faktit se kemi paraqitur tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Përfundimisht nëse AK vazhdon ketë qaje diskriminuese kundër nesh, konkretisht në keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe me qëllim të shkakimit të dëmit të pariparueshëm për ne, ashtu që të na eliminoj përkundër se jemi OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë, ne do të detyrohemi që të ndërmarrim edhe hapa tjerë lidhur me keqpërdorimet e AK-së të sanksionuara me Kod Penal të Republikës së Kosovës. Pretendimet ndaj GOE Muhamet Muçiqi & HARST Group SH.P.K & Valdrini SH.P.K.

AK me të drejtë ka eliminuar GOE Muhamet Muçiqi & HARST Group SH.P.K & Valdrini SH.P.K. pasi që të njëjtit nuk plotësojnë kërkesat sipas nenit 40.6 të RrPP-së për tu konsideruar OE i përgjegjshëm.

Gjithashtu GOE Muhamet Muçiqi & HARST Group SH.P.K & Valdrini SH.P.K nuk ka arritur që t'i argumentoj AK-së se çmimet e ofruara janë në përputhje me çmimet e tregut, posaçërisht sa i përket pozicionit 2, ku me të vërtetë AK ka argumentuar drejt atë se nuk mund të thirresh në kosto minimale për pajisje, ku pjesa dërmuese e pajisjeve janë ofruar me marrëveshje për qira, rrjedhimisht nuk janë në pronësi të GOE në fjalë.

Nëpërmjet Vendimit të OSHP-së OSHP: 2025/0660 është konstatuar se CV e z.Lavdim Bibaj e prezantuar është e pa nënshkruar, përkundër se kjo ka qenë kërkesë e Dosjes së Tenderit, ndërsa AK në kundërshtim me dispozitat ligjore tani këtë pretendim e ka larguar nga arsyet e eliminimit. Bazuar në nenin 10.1 të Udhëzuesit të Prokurimit Publik theksohet qartë: "CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm".

Andaj oferta e GOE Muhamet Muçiqi & HARST Group SH.P.K & Valdrini SH.P.K është administrativisht e papërgjegjshme.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi "AGRO INVEST 1" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues Neni 1 i LPP-së Neni 7 i LPP-së Neni 54 i LPP-së Neni 59 i LPP-së Neni 61.2. i LPP-së Neni 27.14 i RrPP-së Neni 29.4 i RrPP-së Neni 40.1 i RrPP-së Neni 40.6 i RrPP-së Neni 40.12 i RrPP-së Neni 40.13 i RrPP-së Neni 41.8. i RrPP-së Neni 62.2 i RrPP-së. Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, Autoritetit Kontraktues i propozojmë që të marrë këtë: V E N D I M I. APROVOHET si e bazuar Ankesa e GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K. II. ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 05.11.2025, ashtu që lënda kthehet në RIVLERËSIM. III. DETYROHET Autoriteti Kontraktues që të paguaj shpenzimet e procedurës administrative në emër të përgatitjes së Kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankesës për GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K; Rexha SH.P.K; Multi Buisness Group SH.P.K. IV. KTHEHEN mjetet e deponuara në emër të taksës për ankesë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE "AGRO INVEST 1" SH.P.K Operatori ekonomik "Agro Invest 1 shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 14.11.2025 ka paraqitur kërkesë

për rishqyrtim kimdër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhenuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (m meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit sikurse janë formuluar në kërkesën për rishqyrtim, manifestohen ashtu që kundërshtohen të gjitha arsyet për eliminimin e parashtruesit nga aktiviteti i prokurimit. Po ashtu ka prezantuar edhe disa pretendim kundër OE të tjerë sikurse në kërkesën e tij për rishqyrtim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e ehminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese prezantuar në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme.

Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesit e tjerë është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Përndryshe oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar ng aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi shqyrtues i prokurimit me datë 01.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me nr. 1168/2025, me datën 01.12.2025 ka autorizuar ekspertin per ankesën me nr.1170/2025 si dhe me datën 02.12.2025 ka autorizuar ekspertin per shqyrtimin e pretendimeve ankimore per ankesën 1180/2025.

Lidhur me ankesën nr. 1168/2025 me datë 12.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2025/1168 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 1170/2025 me datë 12.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me Nr. 2025/1170 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të

aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 1180/2025 me datë 12.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me Nr. 2025/1180 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës me nr.1168/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertës shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertës shqyrtuese.

Raportin e ekspertizës me nr.1170/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet dhe OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit.

Raportin e ekspertizës me nr.1180/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Muhamet Muçiqi” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1168 ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESË

Grupi i Operatorëve Ekonomik Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini sh.p.k. kanë paraqitur ankesë kundër Kuvendit të Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”. Ankuesi pretendon se është eliminuar në mënyrë të padrejtë, ndonëse ka ofertuar si tenderues i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, duke theksuar se AK ka bazuar eliminimin në kërkesa për specifikime/deklarata teknike që, sipas tij, nuk janë paraparë në Dosjen e Tenderit, si dhe ka trajtuar deklaratat nën betim (Aneksi 2) si të papranueshme. Po ashtu, ankuesi kundërshton vlerësimin e ofertës si ofertë me çmime potencialisht jo-normalisht të ulëta, me arsyetimin se janë dorëzuar sqarime dhe dëshmi të mjaftueshme. Ankuesi pretendon gjithashtu se GOE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e Aneksit 8 për makineri, në veçanti për “kamionetën për bartjen e mbeturinave”, dhe se rekomandimi i ofertës me çmim dukshëm më të lartë nuk është trajtuar në frymën e parimit “vlerë për para”. Sipas ankuesit, AK nuk ka respektuar vendimin e mëparshëm të OSHP-së për rivlerësim dhe ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim pa arsyetim të plotë. Me ankesë kërkohet anulimi i njoftimit mbi vendimin e AK-së dhe kthimi i lëndës në rivlerësim, në përputhje me vendimin e OSHP-së dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga OE “Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini Sh.P.K.” kundër Kuvendit të Komunës së Prishtinës në kuadër të aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”. Pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, dokumentacionit të ofertave, vendimeve të mëparshme të OSHP-së, raportit të Komisionit të rivlerësimit, vendimit të AK-së për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, si dhe dokumenteve të paraqitura nga ankuesi, eksperti paraqet analizën vijuese për secilin pretendim ankimor, si në vijim:

A. Pretendimet kundër eliminimit të ofertës së ankuesit

Pretendimi Ankimor Nr. 1 OE ankues kundërshton arsyetimin e AK-së lidhur me arsyen e eliminimit për mungesë të “specifikimeve teknike të detyrueshme”. Ai thekson se, sipas Dosjes së Tenderit (përfshirë Fletën e të Dhënave dhe Aneksin 1 – Specifikimet teknike/paramasën), nuk ekziston kërkesë e qartë që operatori ekonomik të dorëzojë një dokument të veçantë “Deklaratë mbi specifikimet teknike”, përtej dokumenteve/anekeve të parashikuara në DT. Sipas ankuesit, kërkesa shtesë për një dokument të veçantë nuk ka qenë e publikuar në DT dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përdoret si bazë eliminimi. Ankuesi vlerëson se Komisioni i Rivlerësimit, duke u thirrur në mungesën e një dokumenti që nuk është kërkuar me DT, ka vendosur kërkesë shtesë pas hapjes së ofertave, në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit (neni 7 i LPP-së) dhe me rregullat e vlerësimit/sqarimeve sipas nenit 59 të LPP-së (përfshirë 59.2). Ai shton se AK nuk ka kërkuar sqarime edhe pse çdo paqartësi e mundshme rreth dokumentacionit mund të sqarohet pa ndryshuar përmbajtjen dhe pa ndikuar në renditjen e ofertave. Për këto arsye, OE ankues konsideron se eliminimi i ofertës së tij për këtë shkak është i pabazuar dhe kërkon kthimin e çështjes në rivlerësim sipas kërkesave reale të DT-së.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1: Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, Dosjes së Tenderit (DT/FDT) dhe arsyetimit të eliminimit, vlerëson se çështja thelbësore për shqyrtim lidhet me faktin nëse në DT/FDT është paraparë shprehimisht detyrimi i operatorëve ekonomikë që të dorëzojnë “specifikime teknike” si dokument i veçantë dhe obligativ, përtej dokumenteve të listuara si pjesë e ofertës. Nga përmbajtja e DT-së rezulton se dokumentet që duhet të dorëzohen me tender janë të përcaktuara në nenin 19.1, pa paraparë kërkesë për dokument shtesë të këtij karakteri. Po ashtu, formulimi i Aneksit 1 (“Specifikimet teknike të detyrueshme, sipas përshkrimit teknik – paramasës dhe skicave të projektit të bashkëngjitura në DT”) tregon se specifikimet dhe dokumentacioni teknik janë të hartuar e të bashkëngjitur nga vetë Autoriteti Kontraktues, si bazë për realizimin e punëve, dhe jo dokument që duhet të prodhohet e të dorëzohet nga ofertuesit. Në këto rrethana, eliminimi i OE-së me arsyetimin se “nuk ka dorëzuar specifikimet teknike”, kur një detyrim i tillë dokumentar nuk është i përcaktuar qartë dhe i publikuar në DT/FDT, përbën vendosje të një kërkesë shtesë gjatë fazës së vlerësimit, në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit sipas nenit 7 të LPP-së, si dhe me detyrimin që kërkesat të jenë të përcaktuara paraprakisht dhe qartësisht në dosjen e tenderit (nenet 27 dhe 28 të LPP-së).

Një qasje e tillë bie ndesh edhe me nenin 40.12 të RrPP-së, sipas të cilit tenderuesi nuk mund të përjashtohet për kërkesa që nuk janë të specifikuara në dokumentet e tenderit, si dhe me nenin 40.13 të RrPP-së, që kërkon vlerësim dhe krahasim të ofertave vetëm mbi bazën e kritereve/kërkesave të publikuara.

Po ashtu, neni 59.4 i LPP-së e lidh përgjegjshmërinë e tenderit me përputhshmërinë ndaj kërkesave të njoftimit dhe të DT-së, duke mos lejuar krijimin e kritereve të reja gjatë vlerësimit. Referimi i AK-së në Udhëzuesin Nr. 001/2023 nuk mund të shërbejë si bazë autonome për eliminim, për aq kohë sa kërkesa konkrete për dorëzim të “specifikimeve teknike” nuk është inkorporuar paraprakisht në DT/FDT.

Nëse AK ka pasur paqartësi faktike lidhur me paraqitjen e dokumentacionit në ofertë, këto do të duhej të adresoheshin përmes mekanizmit të sqarimeve sipas nenit 59.2 të LPP-së, për aq sa sqarimi nuk do të ndryshonte përmbajtjen materiale të ofertës. Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi Ankimor Nr. 1 është i bazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 2:

OE ankues kundërshton arsyetimin e AK lidhur me arsyen e eliminimit për shkak të “mosdorëzimit të Deklaratës nën Betim në formën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit – Aneksi 2”. Sipas AK-së, anëtarët e konsorciumit (HARST GROUP SH.P.K. dhe VALDRINI SH.P.K.) kanë dorëzuar deklarata që nuk janë në përputhje me formën standarde të Aneksit 2, me arsyetimin se deklaratat janë “të modifikuara”/jo identike me modelin, përkatësisht për shkak të vendosjes së të dhënave identifikuese në “header” (si dhe elementeve grafike), duke e trajtuar këtë si mospërmbushje që çon në papërgjegjshmëri.

Ankues thekson se deklaratat nën betim janë dorëzuar të nënshkruara nga përfaqësuesit e autorizuar dhe se përmbajtja e kërkuar nga Aneksi 2 është ruajtur plotësisht. Tutje ankuesi thekson se, në kuptim të nenit 44.3 të RrPP-së, vendosja e elementeve identifikuese/grafike (si p.sh. logoja ose “header”-i i kompanisë) nuk e bën deklaratën të pavlefshme, përderisa nuk ka ndërhyrje në përmbajtjen materiale të deklaramit, nuk janë shtuar kushte/kufizime dhe nuk është hequr asnjë pjesë e detyrueshme e tekstit.

Sipas OE-së, ndryshimet e konstatuara nga AK kanë qenë vetëm të natyrës formale (p.sh. vendosje e të dhënave identifikuese në “header”), ndërsa përmbajtja juridike e deklaratës dhe deklaramit e kërkuara nga DT/Aneksi 2 nuk janë ndryshuar. Për këtë arsye, ankuesi vlerëson se AK ka bërë interpretim të gabuar duke e barazuar ndryshimin formal të paraqitjes me “mungesë dokumenti”, duke vendosur një standard më të lartë se sa kërkohet në DT.

Në këto rrethana, OE ankues pretendon se eliminimi për këtë arsye është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit (neni 7 i LPP-së), si dhe me rregullat e vlerësimit vetëm sipas kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit (neni 59 i LPP-së). Andaj, kërkon anulimin e eliminimit për këtë shkak dhe rivlerësimin e ofertës, me arsyetimin se deklaratat e dorëzuara janë në përputhje me kërkesat e DT-së, ndërsa ndryshimet formale të paraqitjes nuk mund të përbëjnë bazë për shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2

Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimit ankimor, rezulton se AK e ka trajtuar GOE-në si të papërgjegjshme me arsyetimin se “nuk keni dorëzuar Deklarata nën Betim duke përdorur formën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit – Aneksi 2”, duke vlerësuar se deklaratat e dorëzuara nga HARST GROUP SH.P.K. dhe VALDRINI SH.P.K. përbëjnë formularë të “modifikuara”, për shkak të vendosjes së elementeve identifikuese në krye të faqes (“header”).

Sipas ekspertit shqyrtues, nga Dosja e Tenderit rezulton se kërkesa për përshtatshmëri, në kuptim të nenit 65 të LPP-së, dëshmohet përmes “Deklaratës nën Betim duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes së Tenderit”. Vetë Aneksi 2 përmban tekstin standard të deklaratës dhe tabelën e identifikimit të operatorit ekonomik, të cilat duhet të plotësohen me të dhënat përkatëse dhe të nënshkruhen/vulosen nga përfaqësuesit e autorizuar.

Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues vlerëson se interpretimi i kërkesës për Aneksin 2 duhet të bëhet në përputhje me nenin 44.3 të RrPPsë. Për më tepër, vetë arsyetimi i AK-së mbështetet në këtë dispozitë, por në të njëjtën kohë ajo, krahas ndalimit të ndryshimeve në përmbajtje, lejon shprehimisht vendosjen e elementeve identifikuese dhe grafike në dokumentet standarde. Konkretisht, neni 44.3 përcakton se

“Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët Ekonomikë gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes ‘header’ apo kudo tjetër në dokumentet standarde.”

Nga krahasimi i kryer ndërmjet deklaratave të dorëzuara nga anëtarët e konsorciumit dhe modelit të Aneksit 2 rezulton se teksti bazë i deklaratës dhe struktura e tabelës së identifikimit janë ruajtur plotësisht, fushat identifikuese janë plotësuar, ndërsa deklaratat janë të nënshkruara dhe të vulosura. Vendosja e titullit apo e të dhënave identifikuese të procedurës në “header”, për aq sa nuk shoqërohet me ndryshim të përmbajtjes materiale të deklaramentit dhe me shtim apo fshirje kushtesh, vlerësohet nga eksperti shqyrtues si përputhje me lejen e shprehur të nenit 44.3 të Rregullores.

Për këto arsye, eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi eliminues për Pretendimin Ankimor Nr. 2 nuk qëndron, përderisa nuk është provuar se deklaratat nën betim kanë pësuar ndryshime materiale në përmbajtjen e tyre. Rrjedhimisht, Pretendimi Ankimor Nr. 2 vlerësohet i bazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 3

OE ankues pretendon se AK, përmes letrës standarde të eliminimit B42 të datës 11.11.2025, e ka eliminuar ofertën e tij me arsyetimin se përmban pozicione me çmime jo-normalisht të ulëta. Sipas AK-së, është iniciuar procedura e verifikimit me B41 më 20.10.2025 (në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41.6 të Rregullores), janë kërkuar sqarime për pozicionet e identifikuar si potencialisht anormalisht të ulëta dhe OE ka kthyer përgjigje më 23.10.2025; megjithatë, AK ka vlerësuar se sqarimet për pozicionin 2 nuk janë bindëse, sepse arsyetimi i OE-së (biznes familjar/kosto e ulët e fuqisë punëtore dhe makinerisë) nuk korrespondon me dokumentacionin e ofertës, pasi nuk janë të qartësuar cilët punëtorë janë “familjar” dhe makineria e prezantuar, sipas AK-së, në pjesën dërmuese rezulton me kontrata për marrje në shfrytëzim. Po ashtu, AK ka vlerësuar se sqarimet për pozicionet 3, 4 dhe 5 nuk janë bindëse, sepse OE, në fazën e sqarimeve, ka ofruar çmime të tregut të datës kur AK ka kërkuar sqarime dhe jo të periudhës para hapjes së ofertave kur OE ka konkurruar me ato çmime, prandaj sqarimet nuk janë llogaritur të pranueshme dhe oferta është eliminuar.

OE ankues kundërshton këtë vlerësim dhe pretendon se AK, gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, ka vepruar në shkelje të LPP-së, përkatësisht të parimit të trajtimit të barabartë dhe

mosdiskriminimit (neni 7), të rregullave të vlerësimit sipas kërkesave/kritereve të dosjes së tenderit (neni 59), si dhe të parimit të përgjegjshmërisë dhe vlerësimit të ofertës më të ulët të përgjegjshme (neni 60), duke theksuar edhe cenim të parimeve të përgjithshme të prokurimit publik (nenet 1 dhe 6). Në këtë kontekst, OE ankues pretendon trajtim të pabarabartë/diskriminues, me arsyetimin se AK nuk i ka pranuar sqarimet e tij, ndërkohë që ka pranuar sqarimet e operatorit të rekomanduar për kontratë edhe kur, sipas ankuesit, ato përmbajnë çmime joreale ose mungesë të zbërthimit të kërkuar, çka – sipas tij – cenon konkurrencën e ndershme dhe bie ndesh me parimet e barazisë dhe vlerësimit sipas kritereve të përcaktuara.

Ankuesi pretendon se AK nuk ka bërë analizë të plotë e të argumentuar të sqarimeve dhe se arsyetimi “çmimet e tregut të datës kur u kërkuar sqarime” nuk ka bazë të qartë në dispozitat e LPP-së dhe Rregullores, prandaj nuk mund të shërbejë si kriter refuzimi. Po ashtu, ankuesi thekson se sqarimet e dhëna më 23.10.2025 kanë përfshirë zbërthim të kostove dhe elementeve relevante dhe se AK është dashur t’i trajtojë ato në përputhje me kërkesat e nenit 41.8 të Rregullores (dhe elementet e vlerësimit përkatës), ose, në rast paqartësish, të kërkojë sqarime të mëtejshme sipas mekanizmit ligjor, e jo të eliminojë ofertën pa arsyetim të verifikueshëm.

OE ankues thekson se çmimet e ofruara janë të realizueshme për shkak të kushteve veçanërisht të favorshme që disponon gjatë ekzekutimit të punëve, përfshirë kapacitetet teknike e profesionale, mekanizmin dhe organizimin e brendshëm të punës të liderit dhe anëtarëve të grupit, si dhe bashkëpunimin afatgjatë në projekte të ngjashme. Sipas OE-së, këto rrethana përbëjnë elemente që duhet të vlerësohen në kuptim të nenit 41.8 të Rregullores, para se një çmim të konsiderohet i paqëndrueshëm. OE thekson gjithashtu se mekanizmat kontraktualë të sigurimit të ekzekutimit (10% e vlerës së kontratës) përbëjnë garanci shtesë për AK lidhur me realizimin e kontratës dhe se, në rast të çdo dyshimi të AK-së për rrezikun e ekzekutimit, OE shprehet i gatshëm të ofrojë masa shtesë sigurie, në vend se të eliminohet pa një analizë të plotë dhe të dokumentuar të sqarimeve.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3:

Pas shqyrtimit të pretendimit të OE ankues dhe dokumentacionit përkatës në platformën elektronike të prokurimit (E-prokurimi), rezulton se çështja kryesore lidhet me mënyrën e zbatimit të dispozitave për çmimet potencialisht jo-normalisht të ulëta, konkretisht nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të RrPP-së, si dhe me standardin e arsyetimit dhe dokumentimit të vendimmarrjes së Autoritetit Kontraktues (AK) në këtë kontekst

Sipas kornizës ligjore, kur një çmim “duket” të jetë potencialisht jo-normalisht i ulët, AK ka të drejtë dhe njëkohësisht detyrim të kërkojë sqarime me shkrim nga operatori ekonomik përmes formularit standard përkatës (B41). Edhe në rastet kur AK ushtron diskrecion profesional në vlerësimin e besueshmërisë së çmimeve, ky diskrecion duhet të ushtrohet në mënyrë të arsyetuar, duke u mbështetur në shqyrtim të kujdesshëm të elementeve relevante dhe në dokumentim të mjaftueshëm e të verifikueshëm.

Në këtë drejtim, neni 41.8 i Rregullores parasheh që gjatë vlerësimit të çmimeve potencialisht jo-normalisht të ulëta, AK të marrë në konsideratë, ndër të tjera, ekonominë e metodave të ndërtimit, zgjidhjet teknike dhe kushtet veçanërisht të favorshme që mund të jenë në dispozicion të operatorit ekonomik.

Nga dokumentet e procedurës rezulton se AK e ka iniciuar procedurën e verifikimit përmes letrës standarde B41 të datës 20.10.2025 dhe ka pranuar sqarimet e OE ankues më 23.10.2025. Në arsyetimin e eliminimit, AK ka vlerësuar se sqarimet e ofruara nga ankuesi nuk kanë qenë bindëse për disa pozicione të paramasës, duke i konsideruar të pamjaftueshme në raport me dokumentacionin e ofertës dhe periudhën përkatëse të ofertimit.

Megjithatë, nga shqyrtimi i tërësishëm i dokumentacionit në platformën E-prokurimi nuk rezulton se për secilin pozicion të kontestuar është zhvilluar një analizë e detajuar dhe e strukturuar, e cila të pasqyrojë në mënyrë të qartë cilët elemente të sqarimeve janë konsideruar të papranueshme dhe arsyet konkrete për një vlerësim të tillë. Arsyetimi i AK-së paraqitet kryesisht në formë konstatimesh të përgjithshme, pa u shoqëruar me krahasime të dokumentuara të kostove, burime referuese të çmimeve apo trajtim të veçantë të faktorëve të parashikuar në nenin 41.8 të Rregullores.

Në pretendim është ngritur gjithashtu çështja e trajtimit të barabartë, duke u theksuar se AK ka kërkuar dhe ka pranuar sqarime edhe nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë për pozicione të identifikuar si potencialisht jo-normalisht të ulëta. Edhe pse vlerësimi i çmimeve përfshin diskrecion profesional të AK-së, është e rëndësishme që ky diskrecion të ushtrohet në mënyrë konsistente dhe me standard të njëjtë vlerësimi për të gjithë operatorët ekonomikë, në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit sipas nenit 7 të LPP-së.

Sa i përket deklaratës së OE ankues për gatishmërinë për rritjen e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, eksperti shqyrtues vlerëson se ky element, ndonëse tregon vullnet për përmbushje të detyrimeve kontraktuale, nuk është vendimtar për vlerësimin e çmimeve potencialisht jo-normalisht të ulëta. Në përputhje me interpretimin e KRPP nr. 21, datë 29.03.2023, 10% përfaqëson minimumin e sigurimit të ekzekutimit dhe vendosja e një përqindjeje më të lartë është e mundur vetëm nëse kjo është e paraparë dhe e publikuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë; për rrjedhojë, në këtë fazë të procedurës, gatishmëria e OE-së për sigurim më të lartë nuk mund të shërbejë si bazë për ndryshim të kriterëve të vlerësimit.

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi Ankimor Nr. 3 është i bazuar

B Pretendimet kundër GOE të rekomanduar për kontratë

Pretendimi Ankimor Nr. 1

Ankuesi pretendon se, bazuar në Aneksin 8 të Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT), lidhur me makineritë dhe pajisjet që GOE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka qenë i obliguar t'i dëshmojë, ky i fundit nuk i përmbush kërkesat përkatëse, ashtu siç është konstatuar edhe në Raportin e Ekspertit Shqyrtues nr. 2025/0661 të datës 29.07.2025. Ankuesi thekson se këto konstatime janë konfirmuar edhe me Vendimin e Panelit Shqyrtues (PSH) nr. 2025/0661 të datës 16.09.2025, me të cilin ankesa është aprovuar si e bazuar dhe PSH është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues, duke ia dhënë besimin

Ankuesi vë në pah se në raportin e ekspertit, konkretisht në pretendimin nr. 6 (faqe 14), është vlerësuar se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik i rekomanduar nuk dëshmon posedimin dhe funksionalitetin e pajisjeve të kërkuara sipas Aneksit 8, prandaj kriteri përkatës nuk konsiderohet i përmbushur. Megjithatë, ankuesi pretendon se Komisioni i Rivlerësimit, edhe

përkundër Vendimit të PSH-së dhe konstatimeve të raportit të Ekspertit Shqyrtues, ka vepruar ndryshe në rivlerësim, duke e konsideruar GOE të rekomanduar si të përgjegjshëm pa u arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar për dallimin nga konstatimet e mëparshme. Sipas ankuesit, një qasje e tillë cenon konsistencën e vlerësimit dhe respektimin e kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, si dhe krijon pasiguri në zbatimin e vendimeve të organit shqyrtues.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1:

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe dokumentacionit përkatës, eksperti shqyrtues vëren se çështja e përmbushjes së kërkesave të Aneksit 8 të FDT-së nga GOE i rekomanduar për kontratë është trajtuar tashmë në raportin paraprak të ekspertit shqyrtues, ku është konstatuar se operatorit të rekomanduar i mungojnë pajisje të caktuara të obligueshme, sipas kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Këto konstatime janë bërë pjesë e raportit të ekspertit shqyrtues në lëndën përkatëse dhe janë pranuar nga Paneli Shqyrtues, i cili, në vendimet e tij me numra OSHP: 2025/0643, 2025/0657, 2025/0660 dhe 2025/0661, të datës 16.09.2025, duke i falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues.

Në këto rrethana, duke qenë se kjo çështje është tashmë e trajtuar dhe e konfirmuar nga Paneli Shqyrtues, vlerësimi lidhur me përmbushjen e kërkesave të Aneksit 8 duhet të mbetet në përputhje me raportin paraprak të ekspertit shqyrtues dhe vendimet përkatëse të OSHP-së, pa u devijuar nga konstatimet e tyre, në mungesë të rrethanave të reja apo provave shtesë të dokumentuara.

Pretendimi Ankimor Nr. 2

Ankuesi pretendon se AK, përkatësisht Komisioni i Ri-Vlerësimit, ka vepruar në kundërshtim me LPP-në dhe aktet nënligjore, duke pranuar sqarimet dhe ofertën financiare të GOE të rekomanduar për kontratë, ndonëse çmimet e këtij operatori janë dukshëm më të larta se çmimet orientuese të paramasës/parallogarisë dhe, për disa pozicione, paraqiten joproporcionale dhe të pambështetura me analizë të mjaftueshme të kostos.

Sipas ankuesit, nga tabela krahasuese e çmimeve rezulton se për disa pozicione të paramasës, GOE i rekomanduar ka ofruar çmime shumëfish më të larta se ato të ankuesit dhe mbi vlerat orientuese të përlllogaritura nga vetë AK. Ankuesi thekson se, pavarësisht këtyre dallimeve të theksuara, AK nuk ka kërkuar nga GOE i rekomanduar zbërthim të detajuar dhe të verifikueshëm të kostove, ose, nëse ka kërkuar sqarime, i ka pranuar ato pa një analizë të dokumentuar dhe krahasimore, në kundërshtim me standardin që i është aplikuar ankuesit.

Ankuesi pretendon se AK ka zbatuar standarde të ndryshme vlerësimi: nga njëra anë, ka refuzuar sqarimet e ankuesit duke i cilësuar si “të pabesueshme” apo “në kundërshtim me ofertën”, ndërsa nga ana tjetër ka pranuar sqarimet e GOE të rekomanduar edhe kur ato nuk përmbajnë zbërthim të plotë të elementeve të kostos, nuk arsyetojnë diferencat e larta të çmimeve dhe nuk dëshmojnë proporcionalitet me paramasën dhe tregun.

Në këtë mënyrë, sipas ankuesit, AK ka cenuar parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë (neni 7 i LPP-së), parimin e transparencës dhe konkurrencës së ndershme (nenet 1 dhe 6 të LPP-së), si dhe rregullat e vlerësimit sipas kriterëve

të përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit (neni 59 i LPP-së). Ankuesi thekson se çdo vlerësim i çmimeve duhet të jetë i njëjtë për të gjithë operatorët dhe i bazuar në analiza të krahasueshme, objektive dhe të dokumentuara, pa krijuar avantazh të pajustificuar për asnjë ofertues.

Për më tepër, ankuesi pretendon se pranimi i ofertës së GOE të rekomanduar me çmime dukshëm më të larta, pa analizë të thelluar të arsyeshmërisë dhe proporcionalitetit të tyre, cenon edhe parimin e përdorimit efikas të fondeve publike dhe konceptin e “vlerës për para”, duke ekspozuar buxhetin e Komunës ndaj shpenzimeve të panevojshme.

Për këto arsye, ankuesi kërkon që pretendimi të pranohet si i bazuar dhe që AK të obligohet të kryejë rivlerësim të plotë dhe të njëtrajtshëm të ofertave financiare, duke aplikuar të njëjtat kritere dhe standarde vlerësimi edhe ndaj GOE të rekomanduar për kontratë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Dosjen e Tenderit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2:

Pas shqyrtimit të pretendimit të OE ankues dhe dokumentacionit të publikuar në platformën E-Prokurimi, rezulton se çështja e ngritur lidhet me trajtimin e çmimeve të ofertës së GOE të rekomanduar për kontratë dhe me arsyetimin e pranimit të saj, në rrethana kur për disa pozicione çmimet paraqiten dukshëm më të larta se vlerat orientuese të paramasës/parallogarisë. Nga dosja rezulton se AK ka zhvilluar verifikim dhe arsyetim kryesisht në raport me çmimet potencialisht jo-normalisht të ulëta, ndërsa nuk është gjetur asnjë analizë e dokumentuar që të jetë trajtuar ndonjë ofertë për shkak të çmimeve dukshëm të larta, përfshirë vlerësimin e proporcionalitetit/arsyeshmërisë së çmimeve të GOE të rekomanduar dhe bazën krahasimore mbi të cilën është konsideruar e pranueshme oferta e tij. Kjo merr rëndësi të veçantë sidomos kur GOE i rekomanduar për kontratë nuk është ofertuesi me çmimin më të ulët, prandaj arsyetimi dhe dokumentimi i vendimmarrjes duhet të jetë i qartë dhe i verifikueshëm në dosje. Në mungesë të një analize të tillë, vendimmarrja mbetet e paverifikueshme sa i përket transparencës dhe konsistencës së standardeve të vlerësimit, prandaj Pretendimi Ankimor Nr. 2 vlerësohet i bazuar në aspektin e mungesës së analizës së dokumentuar për trajtimin e çmimeve të larta dhe nevojës për rivlerësim me arsyetim të plotë e të njëtrajtshëm.

C. Pretendimi për trajtimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe zbatimin e vendimit të OSHP-së:

Pretendimi Ankimor Nr. 3:

Ankuesi pretendon se AK, përkatësisht Komisioni i Ri-Vlerësimit (ZPP), ka vepruar në kundërshtim me LPP-në duke refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe duke nxjerrë vendim pa respektuar detyrimet që burojnë nga vendimet përfundimtare të Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Sipas ankuesit, në vendimet e OSHP-së me numra 2025/0643, 2025/0657, 2025/0660 dhe 2025/0661, të datës 16.09.2025, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë raporteve të ekspertëve shqyrtues, duke konstatuar shkelje në procesin e vlerësimit dhe duke obliguar AK-në që, në fazën e rivlerësimit, të veprojë në përputhje të plotë me këto gjetje.

Megjithatë, ankuesi thekson se AK, në procesin e ri-vlerësimit, nuk i ka zbatuar këto vendime, por ka ripërsëritur të njëjtat arsye eliminimi dhe të njëjtat qëndrime, pa i korrigjuar shkeljet e konstatuara nga OSHP. Në këtë mënyrë, sipas ankuesit, AK ka shkelur detyrimin ligjor për zbatim të vendimeve të OSHP-së dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, si

dhe me nenet 59 dhe 60 të LPP-së, që rregullojnë detyrimin për vlerësim të bazuar në fakte, prova dhe arsyetim të dokumentuar.

Ankuesi gjithashtu pretendon se AK ka aplikuar standarde të dyfishta në vlerësim, duke treguar qasje diskriminuese dhe selektive, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së (trajtim i barabartë dhe mosdiskriminim), si dhe duke cenuar parimet e transparencës, konkurrencës së ndershme dhe përdorimit efikas të fondeve publike, të garantuara me nenet 1 dhe 6 të LPP-së.

Sipas ankuesit, refuzimi i kërkesës për rishqyrtim dhe moszbatimi i drejtpërdrejtë i vendimeve të OSHP-së e bëjnë procesin e rivlerësimit formal dhe jo real, duke e privuar ankuesin nga e drejta për trajtim të barabartë dhe vlerësim objektiv të ofertës së tij.

Për këto arsye, ankuesi kërkon që Pretendimi Ankimor Nr. 3 të pranohet si i bazuar dhe që Autoriteti Kontraktues të obligohet të zbatojë plotësisht dhe pa devijime vendimet përfundimtare të OSHP-së, duke kryer një rivlerësim real, të paanshëm dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3:

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të pretendimit të OE ankues, Dosjes së Tenderit, vendimeve të OSHP-PSH nr. 2025/0661, 2025/0643, 2025/0657 dhe 2025/0660, si dhe veprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues pas kthimit të lëndës në rivlerësim, vlerëson si vijon:

1. Korniza ligjore

Neni 108/A i LPP-së përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues që, pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, të zhvillojë një shqyrtim efektiv dhe real të pretendimeve dhe të nxjerrë një vendim të arsyetuar brenda afateve ligjore. Po ashtu, neni 97 i Rregullores për Prokurim Publik (RrPP) obligon AK-në që vendimet e OSHP-PSH t'i zbatojë në mënyrë efektive, në përputhje me dispozitivin dhe arsyetimin e tyre.

Në të njëjtën kohë, nenet 1 dhe 6 të LPP-së sanksionojnë parimet e transparencës dhe përdorimit efikas të fondeve publike, neni 7 garanton trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin, ndërsa nenet 59 dhe 60 kërkojnë që ekzaminimi, vlerësimi dhe vendimmarrja e Autoritetit Kontraktues të bazohen në kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe të shoqërohen me arsyetim të mjaftueshëm, objektiv dhe të verifikueshëm.

2. Vlerësimi i veprimeve të Autoritetit Kontraktues

Nga aktet e dosjes rezulton se, pas nxjerrjes së vendimit të OSHP-PSH nr. 2025/0661, Autoriteti Kontraktues ka kthyer aktivitetin në rivlerësim, ka emëruar Komision të Ri-Vlerësimit dhe ka ndërmarrë veprime procedurale në drejtim të rivlerësimit të ofertave, përfshirë shqyrtimin e dokumentacionit dhe nxjerrjen e një vendimi të ri lidhur me dhënien e kontratës. Në këtë aspekt, nuk rezulton se AK ka refuzuar në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin e vendimit të OSHP-PSH apo se ka neglizhuar detyrimin formal për rivlerësim.

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit, eksperti shqyrtues vëren se disa çështje substanciale, të cilat kanë qenë objekt i shqyrtimit paraprak nga OSHP-PSH, nuk rezultojnë të jenë adresuar në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme në kuadër të rivlerësimit të kryer nga Autoriteti Kontraktues. Në veçanti, çështja e përmbushjes së kërkesave të Aneksit 8 të FDT-së nga GOE i rekomanduar për kontratë është trajtuar tashmë në raportin paraprak të ekspertit

shqyrtues, ku është konstatuar mungesa e pajisjeve të caktuara obliguese sipas Dosjes së Tenderit.

Nga dokumentacioni i rivlerësimit nuk evidentohet se kjo çështje është trajtuar në mënyrë të posaçme nga Komisioni i Ri-Vlerësimit, as se është dhënë ndonjë arsyetim i veçantë dhe i dokumentuar lidhur me devijimin eventual nga përfundimet e raportit paraprak të ekspertit shqyrtues, pavarësisht se këto gjetje kanë qenë pjesë përbërëse e bazës mbi të cilën Paneli Shqyrtues i OSHP-së i ka falur besimin e plotë raportit përkatës.

Në këtë kontekst, pa paragjykuar diskrecionin e Autoritetit Kontraktues për të rivlerësuar ofertat, mbetet thelbësore që zbatimi i vendimit të OSHP-PSH të reflektohet jo vetëm përmes ndërmarrjes së hapave proceduralë, por edhe përmes adresimit substancial të gjetjeve dhe udhëzimeve që burojnë nga vendimi dhe raporti mbi të cilin Paneli ka mbështetur qëndrimin e tij. Ky standard rrjedh nga neni 97 i RrPP-së dhe nga kërkesa e nenit 108/A të LPP-së për shqyrtim efektiv dhe vendimmarrje të arsyetuar.

Po ashtu, në rast se disa çështje të ngritura nga ankuesi mbeten pa trajtim të mjaftueshëm në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim dhe në arsyetimin e rivlerësimit, kjo e bën të vështirë verifikimin e respektimit praktik të parimit të trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit sipas nenit 7 të LPP-së, si dhe të standardeve të transparencës dhe arsyetimit të vendimmarrjes në kuptim të neneve 1, 6, 59 dhe 60 të LPP-së.

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë veprime formale për rivlerësim pas vendimit të OSHP-PSH nr. 2025/0661; megjithatë, nga dokumentacioni nuk rezulton se janë adresuar qartë dhe në mënyrë të verifikueshme të gjitha çështjet substanciale që kanë qenë objekt i trajtimit paraprak (përfshirë gjetjet lidhur me Aneksin 8), çka e bën të paqartë nivelin e zbatimit efektiv të vendimit në kuptim të nenit 97 të RrPP-së dhe standardit të shqyrtimit efektiv sipas nenit 108/A të LPP-së. Për rrjedhojë, Pretendimi Ankimor Nr. 3 vlerësohet pjesërisht i bazuar.

PËRFUNDIMI

Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së prokurimit, pretendimeve ankimore dhe analizës së mësipërme, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar.

Nga shqyrtimi rezulton se, gjatë rivlerësimit, AK nuk ka arritur të sigurojë trajtim të barabartë të OE-ve, veçanërisht në trajtimin e çmimeve potencialisht jo-normalisht të ulëta: megjithëse janë kërkuar sqarime nga OE ankues, nuk rezulton arsyetim i mjaftueshëm dhe i verifikueshëm mbi bazën faktike të pranimit/refuzimit të sqarimeve dhe mbi realitetin e çmimeve. Po ashtu, janë trajtuar elemente që nuk pasqyrohen qartësisht si kërkesa të DT-së, si dhe çështje formale (përfshirë Deklaratën nën Betim – Aneksi 2), ku ndryshimet vetëm në paraqitje janë vlerësuar me efekt eliminues pa u dëshmuar ndryshim material i përmbajtjes.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i rivlerësimit nuk evidentohet se Komisioni i Ri-Vlerësimit ka trajtuar në mënyrë të qartë dhe substanciale gjetjet e raportit paraprak të ekspertit shqyrtues lidhur me mospërmbushjen e kërkesave të Aneksit 8 të Dosjes së Tenderit nga GOE i rekomanduar për kontratë. Këto gjetje kanë qenë bazë e vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së; megjithatë, nga rivlerësimi nuk rezulton arsyetim i dokumentuar që të shpjegojë devijimin nga to, çka tregon mungesë të zbatimit efektiv të vendimit të OSHP-së në kuptim të nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 97 të Rregullores për Prokurim Publik.

Në këto rrethana, rekomandohet që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe çështja të kthehet në rivlerësim, në mënyrë që AK të zhvillojë vlerësim të plotë, të paanshëm dhe të dokumentuar në pajtim me nenet 1, 6, 7 dhe 59 të LPP-së.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “VIA EGNATIA” SH.P.K Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1170 ka vlerësuar se:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Grupi i OE “VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SHPK Dega në Kosovë” ka paraqitur ankesë kundër Kuvendit të Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”. Ankuesi pretendon se është eliminuar padrejtësisht edhe pas urdhërit të OSHP-së për ri-vlerësim, duke theksuar se Autoriteti Kontraktues ka keqinterpretuar kriterin për kontratat e ngjashme dhe nuk i ka trajtuar drejt dokumentet e dorëzuara. Sipas ankesës, AK ka zbatuar standarde të dyfishta ndaj OE-ve, duke kërkuar sqarime selektive vetëm për një kontratë dhe jo në mënyrë të plotë sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së, si dhe duke toleruar mospërputhje në ofertat e tenderuesve tjerë, ndërsa ofertën e tyre e ka eliminuar pa bazë. Ankuesi kërkon anulimin e vendimit të AK-së dhe ri-vlerësim objektiv të ofertes së tyre, të cilën e konsideron tenderin më të favorshëm ekonomikisht nga tenderët e përgjegjshëm.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes ankesën e paraqitur nga grupi i OE “VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SHPK Dega në Kosovë” kundër Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila lidhet me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”. Në kuadër të analizës janë shqyrtuar dosja e tenderit, vendimi i Autoritetit Kontraktues, vendimi i mëparshëm i OSHP-së për këtë rast, si dhe dokumentet dhe pretendimet e paraqitura nga pala ankuese.

Duke u bazuar në këto dokumente dhe në dispozitat relevante të LPP-së dhe akteve nënligjore, eksperti shqyrtues vlerëson si vijon:

Pretendimi ankimor Nr. 1:

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1 të LPP-së, pasi gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka siguruar administrim efikas, efektiv dhe transparent të procedurës së prokurimit. Sipas ankuesit, AK ka dështuar të zbatojë në mënyrë të drejtë dhe objektive kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, duke eliminuar ofertën e tyre nga konkurrenca edhe pse ata pretendojnë se kanë dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për realizimin e projekteve të kërkuara.

Ankuesi thekson se AK nuk e ka aplikuar në mënyrë të drejtë procedurën e sqarimeve sipas neneve 59 dhe 72 të LPP-së dhe nuk ka respektuar kërkesat e vendimit paraprak të OSHP-së, gjë që, sipas tij, ka çuar në krijimin e standardeve të dyfishta: tenderuesi që, sipas tyre, është i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët nuk është trajtuar drejt, ndërsa fitues është shpallur një tenderues tjetër i papërgjegjshëm.

Në përfundim, ankuesi pohon se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së duke mos e vlerësuar ofertën e tyre në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me parimet e efikasitetit, efektivitetit dhe

transparencës, si dhe duke dështuaren të sigurojë përdorim sa më të drejtë dhe racional të fondeve publike.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1:

Neni 1 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë administrimin efikas, efektiv dhe transparent të procedurave, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe përdorimin sa më të favorshëm dhe racional të fondeve publike. Këto parime realizohen në praktikë përmes zbatimit korrekt të dispozitave konkrete të ligjit, veçanërisht neneve 59, 60 dhe 72 të LPP-së dhe akteve nënligjore përkatëse.

Nga shqyrtimi i dosjes së tenderit dhe i procesit të rivlerësimit rezulton se në vlerësimin e ofertës së ankuesit janë evidentuar mangësi procedurale, në veçanti sa i përket analizimit të kontratave të ngjashme dhe përdorimit të instrumentit të sqarimeve. Sqarimet nuk janë shfrytëzuar në mënyrë të plotë dhe të njëtrajtshme për të gjitha kontratat e paraqitura, ndërsa arsyetimi për mospranimin e një pjese të tyre si kontrata të ngjashme nuk rezulton të jetë i mjaftueshëm dhe i dokumentuar. Këto rrethana tregojnë se procesi i rivlerësimit nuk e ka arritur plotësisht standardin e qartësisë dhe transparencës që synohet nga parimet e nenit 1 të LPP-së.

Kjo merr rëndësi të veçantë në rrethanat kur ankuesi pretendon se ka ofruar çmimin më të ulët, çka kërkon nga Autoriteti Kontraktues kujdes të shtuar në arsyetimin dhe dokumentimin e vendimmarrjes, në funksion të garantimit të përdorimit sa më racional të fondeve publike.

Në anën tjetër, nga të dhënat e dosjes nuk rezultojnë elemente që do të lejonin konkludimin se Autoriteti Kontraktues ka vepruar me qëllim të hapur diskriminues apo në kundërshtim të qëllimshëm me parimet e nenit 1 të LPP-së. Proces i rivlerësimit është zhvilluar në vijim të vendimit paraprak të OSHP-së dhe janë ndërmarrë veprime procedurale, përfshirë edhe përdorimin e sqarimeve, megjithëse jo në mënyrën më të plotë, më konsistente dhe më të dokumentuar të mundshme.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi për shkelje të nenit 1 të LPP-së është pjesërisht i bazuar, në atë masë që mangësitë e konstatuara në vlerësimin e ofertës së ankuesit cenojnë realizimin e plotë të parimeve të transparencës, efikasitetit dhe përdorimit sa më të favorshëm të fondeve publike, por jo në atë nivel sa të konstatohet shkelje e plotë dhe e qëllimshme e parimeve themelore të parashikuara në këtë nen.

Pretendimi Ankimor Nr. 2:

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 7 të LPP-së, pasi gjatë rivlerësimit të tenderëve nuk ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. Sipas tij, AK ka eliminuar ofertën e tyre edhe pse, sipas dosjes së tenderit, ata plotësonin kriterin për kontrata të ngjashme, gjë të cilën e kishte konstatuar edhe OSHP-ja në vendimin e saj të mëparshëm.

Ankuesi thekson se AK ka kërkuar sqarime vetëm për një kontratë e cila nuk ishte relevante, ndërsa nuk ka kërkuar sqarime për kontratat tjera ku kriteri ishte plotësuar qartë, duke shkaktuar diskriminim dhe trajtim të pabarabartë. Ata argumentojnë se ky veprim bie ndesh me nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së, pasi sqarimet duhet të kërkojnë vetëm aty ku ka paqartësi reale dhe jo për kontrata ku kriteri është i dokumentuar mjaftueshëm.

Sipas ankuesit, AK ka zbatuar ligjin në mënyrë selektive: ka eliminuar kontrata të vlefshme të tyre pa nevojë për sqarim, ndërsa ka toleruar mangësi në ofertën e GOE të shpallur fitues. Kjo,

sipas tyre, përbën favorizim të fituesit dhe diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj tenderit të ankuesit, sidomos duke pasur parasysh se ata kanë ofertuar çmim më të ulët se tenderuesi i shpallur fitues.

Në përfundim, ankuesi vlerëson se AK ka shkelur plotësisht nenin 7 të LPP-së duke mos trajtuar tenderuesit në mënyrë të barabartë dhe transparente, dhe duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë procedurat e sqarimit dhe vlerësimit të kontratave të ngjashme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2:

Neni 7 i LPP-së parasheh parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminues të operatorëve ekonomikë, duke kërkuar që Autoriteti Kontraktues t'i zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit në mënyrë të njëtrajtshme dhe të krahasueshme për të gjithë tenderuesit. Ky parim përfshin, ndër të tjera, edhe mënyrën se si vlerësohen kontratat e ngjashme dhe si përdoret instrumenti i sqarimeve gjatë procesit të vlerësimit.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dosjes rezulton se, lidhur me përvojën e mëparshme të ankuesit, Autoriteti Kontraktues është fokusuar në një kontratë të vetme përmes kërkesës për sqarim, ndërkohë që për kontratat e tjera të listuara nuk është ndërmarrë e njëjta qasje analitike dhe nuk është dhënë arsyetim i mjaftueshëm dhe i dokumentuar lidhur me arsyet pse ato nuk janë pranuar si kontrata të ngjashme. Në këto rrethana, nuk rezulton se dokumentacioni i ofertës së ankuesit është trajtuar në mënyrë tërësore dhe të njëtrajtshme në raport me standardin e verifikimit dhe sqarimit që kërkohet nga neni 7 i LPP-së.

Megjithatë, nga aktet e dosjes nuk rezultojnë elemente të mjaftueshme për të konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar me qëllim të hapur diskriminues apo favorizues ndaj ndonjë operatori ekonomik. Mangësitë e konstatuara lidhen kryesisht me mënyrën e zbatimit dhe arsyetimit të procesit të rivlerësimit, dhe jo domosdoshmërisht me shkelje të qëllimshme të parimit të trajtimit të barabartë.

Për këto arsye, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi Ankimor Nr. 2 është pjesërisht i bazuar, në aspektin se gjatë rivlerësimit nuk është siguruar plotësisht aplikimi i njëtrajtshëm dhe i krahasueshëm i standardit të verifikimit dhe sqarimit të kontratave të ankuesit, ashtu siç kërkohet nga neni 7 i LPP-së.

Pretendimi Ankimor Nr. 3:

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RRPP-001/2022, sepse, sipas ankuesit, gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka respektuar kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për trajtimin e devijimeve të vogla dhe nuk ka përdorur institutin e sqarimeve në mënyrë të drejtë e të paanshme. Sipas ankuesit, AK ka përdorur arsye të paqëndrueshme për eliminimin e ofertës së tyre, duke e reduktuar analizën vetëm te një kontratë e vetme, ndërkohë që lista e kontratave të dorëzuara nga grupi i OE-së i përmbush kërkesat për kontrata të ngjashme në aspektin e vlerës, natyrës dhe përmasës së punimeve.

Ankuesi thekson se, sipas nenit 59.4 të LPP-së, çdo paqartësi që lidhet me dokumentacionin e ofertës trajtohet si devijim i vogël, i korrigjueshëm dhe i zgjidhshëm përmes sqarimeve, por se AK nuk e ka zbatuar këtë standard ligjor. Në vend të kësaj, AK ka kërkuar sqarime vetëm për një kontratë që, sipas ankuesit, nuk ishte përcaktuese, duke mos marrë në konsideratë kontratat e tjera të paraqitura, të cilat, sipas tyre, përmbushnin plotësisht kriterin e kërkuar prej 780,000 €.

Ankuesi vlerëson se kërkesa për sqarime është përdorur si mjet për eliminim, e jo për qartësimin e dokumenteve, duke e devijuar qëllimin e procedurës dhe duke cenuar konkurrencën.

Në vijim, ankuesi pretendon se AK ka keqinterpretuar kërkesën e DT-së për kontrata të ngjashme dhe ka aplikuar në mënyrë të gabuar logjikën “kalon/nuk kalon”, duke mos njohur asnjë nga kontratat që, sipas ankuesit, realisht janë të ngjashme dhe të mjaftueshme. Kjo qasje, sipas ankuesit, bie ndesh edhe me vendimin e mëparshëm të OSHP-së, i cili kishte urdhëruar rivlerësim objektiv dhe të plotë të ofertës së tyre.

Trajtimi i pabarabartë dhe standardet e dyfishta ndaj OE-ve të tjerë

Ankuesi pretendon se AK nuk ka aplikuar të njëjtin standard vlerësimi për të gjithë tenderuesit, duke toleruar devijime shumë më serioze tek OE-të e tjerë, ndërkohë që ndaj tyre ka vepruar në mënyrë eliminatorie për elemente të korrigjueshme. Sipas ankuesit, shembujt e mëposhtëm dëshmojnë trajtim të pabarabartë dhe aplikim selektiv të ligjit.

Grupi i OE “Muhamet Muçiqi B.I.; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.”

- Sipas ankuesit, anëtari Eco Clean (Muhamet Muçiqi B.I.) nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me kërkesën për kontratat e ngjashme, që është kriter thelbësor për përgjegjshmëri.
- Ankuesi pretendon se damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete 05/L-132 (vetëm dud), çka i bën të papranueshëm si mjete të gatshme për ekzekutimin e kontratës.
- Po ashtu, sipas ankuesit, është dorëzuar një CV për teknikun, e cila nuk përmban informacionet e nevojshme profesionale dhe është e pa-nënshkruar nga personi përkatës.

Grupi i OE “AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha”

- Sipas ankuesit, anëtari Multi Business Group SH.P.K. ka dorëzuar raportin e vlerësimit të riskut, por mungon licenca e kompanisë së licencuar për ushtrimin e aktivitetit profesional të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Në të gjitha marrëveshjet e dorëzuara, sipas ankuesit, mungon emërtimi i pajisjeve, pra pajisjet nuk janë të specifikuara sipas kërkesës së DT-së.
- Ankuesi pretendon se damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete 05/L-132, që i bën të papranueshëm sipas kërkesës për dokumentacion të vlefshëm.
- Gjithashtu, ankuesi thekson se mungon marrëveshja me NTSH Gjyli Komerc, e cila është deklaruar si burim pajisjesh.

Mangësitë e OE-së së shpallur fitues – Grupi i OE “N & B SH.P.K.; BM Group SH.P.K.”

Përpos këtyre rasteve, ankuesi thekson se edhe vet GOE i shpallur fitues, megjithëse ka çmim më të ulët se disa OE të tjerë, paraqet mangësi serioze që, sipas tyre, duhet ta bënë tenderin e tyre të papërgjegjshëm. Sipas ankuesit, këto mangësi janë si vijon:

- Sipas ankuesit, ky grup nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për kontratat e ngjashme. Kontratat e dorëzuara nga ky grup, sipas tyre, nuk janë të përafërta me natyrën e projektit, sidomos kur krahasohen me kontratat e ankuesit, të cilat AK i ka refuzuar. Në këto rrethana, ankuesi vlerëson se kontratat e fituesit nuk është dashur të pranohen.

- Ankuesi pretendon se damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete 05/L-132 (vetëm dud). Vetë kërkesa e AK-së është që automjetet dhe pajisjet e regjistrueshme duhet të shoqërohen me librezë qarkullimi, por, sipas ankuesit, ky OE nuk ka dorëzuar librezë, duke e bërë ofertën e tyre të papërgjegjshme.

Mbi bazën e të gjitha rrethanave të paraqitura më lart, ankuesi pretendon se tenderi i tyre është oferta me çmimin më të ulët ndër të gjithë tenderët e përgjegjshëm dhe se, sipas tyre, plotëson në tërësi të gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara nga Dosja e Tenderit për t'u shpërblyer me kontratë. Ankuesi thekson se mosveprimi i AK-së gjatë procesit të rivlerësimit, mosrespektimi i detyrimeve ligjore për sqarimin e tenderëve dhe moszbatimi i kërkesave të vendimit të OSHP-së, si dhe mosrespektimi i Ligjit për Automjete nr. 05/L-132, e kanë çuar AK-në, sipas ankuesit, drejt shkeljes së nenit 59 të LPP-së dhe drejt marrjes së një vendimi të padrejtë dhe të paarsyeshëm në dëm të ofertës së tyre

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3:

Pretendimi i ankuesit lidhet kryesisht me mënyrën e rivlerësimit të përvojës së mëparshme përmes kontratave të ngjashme, në kuptim të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenit 40 të Rregullores për Prokurim Publik nr. RRPP-001/2022, si dhe me pretendimet për trajtim të pabarabartë dhe aplikim të standardeve të dyfishta ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë.

1. Vlerësimi i kontratave të ngjashme të ankuesit dhe përdorimi i institutit të sqarimeve

Sipas Fletës së të Dhënave të Tenderit, operatorët ekonomikë kanë qenë të obliguar të dëshmojnë realizimin me sukses të kontratave të ngjashme me objektin e prokurimit, në vlerë minimale prej 780,000.00 € në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, përmes listës së kontratave të realizuara dhe dokumentacionit mbështetës përkatës.

Kërkesa për “kontrata të ngjashme” në Dosjen e Tenderit është formuluar në mënyrë të përgjithshme, pa përkufizim të detajuar teknik apo funksional të ngjashmërisë së kërkuar. Në këtë kontekst, në raportet paraprake të ekspertit shqyrtues, të miratuara nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, ishte konstatuar se ankuesi kishte dorëzuar listën e kontratave të realizuara, të shoqëruara me dokumentacion përkatës, dhe se një pjesë e këtyre kontratave përmbanin elemente të natyrës së ngjashme me objektin e kontratës. Eksperti kishte theksuar se, në rast se Autoriteti Kontraktues kishte paqartësi lidhur me ndonjë kontratë të veçantë, duhej të shfrytëzonte mundësinë e sqarimeve sipas nenit 59 të LPP-së, përpara se të vendoste eliminimin e ofertës.

Në rivlerësimin aktual, nga dokumentacioni rezulton se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime vetëm për një kontratë specifike nga lista e kontratave të ankuesit, ndërkohë që për kontratat e tjera nuk është reflektuar një analizë përmbajtësore e plotë dhe e strukturuar lidhur me ngjashmërinë e tyre në aspektin funksional, teknik dhe vleror.

Nga përgjigjja e ankuesit, e datës 30.10.2025, rezulton se ky i fundit ka zgjedhur të mos dorëzojë dokumentacion shtesë për kontratën specifike për të cilën Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar sqarime, duke theksuar se kriteri i realizimit të kontratave të ngjashme është tashmë i përmbushur përmes kontratave të tjera të listuara dhe se kjo çështje është trajtuar në vendimin paraprak të OSHP-së. Edhe pse ky qëndrim i ankuesit është i argumentuar nga perspektiva e tij, mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar ka kufizuar mundësinë e Autoriteti Kontraktues për të verifikuar drejtpërdrejt elementet e asaj kontrate specifike.

Megjithatë, kjo rrethanë nuk e zhbën detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të vlerësuar në mënyrë të plotë, gjithëpërfshirëse dhe jo selektive kontratat e tjera të dorëzuara nga ankuesi dhe për të arsyetuar qartë se cilat prej tyre janë pranuar ose refuzuar si “të ngjashme” dhe mbi çfarë baze konkrete. Nga vendimi i rivlerësimit nuk rezulton se një analizë e tillë është reflektuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të verifikueshme.

Duke u bazuar në dokumentet e ofertës, në parimet e interpretimit proporcional të përvojës dhe në udhëzimet e vendimit paraprak të OSHP-së, ekspertit shqyrtues vlerëson se procesi i rivlerësimit nuk ka arritur standardin e kërkuar të analizës së plotë dhe të përdorimit konsistent të mekanizmit të sqarimeve sipas nenit 59.2 të LPP-së. Për këtë arsye, pretendimi i ankuesit në këtë pjesë vlerësohet pjesërisht i bazuar.

2. Pretendimet për trajtim të pabarabartë dhe standarde të dyfishta ndaj OE-ve të tjerë

Sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë, përkatësisht ndaj Grupit të OE “Muhamet Muçiqi B.I.; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.”, Grupit të OE “AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha”, si dhe GOE-së së shpallur fitues – Grupi i OE “N & B SH.P.K.; BM Group SH.P.K.”, ekspertit shqyrtues vlerëson se këto pretendime janë të njëjta dhe të ripërsëritura, dhe si të tilla janë trajtuar tashmë në raportet paraprake të ekspertit shqyrtues në lëndët OSHP nr. 2025/0643, 2025/0657, 2025/0660 dhe 2025/0661, të cilave Paneli Shqyrtues i OSHP-së u ka falur besimin e plotë.

Në kuadër të rivlerësimit aktual nuk janë paraqitur fakte të reja, dokumente shtesë apo rrethana të ndryshuara që do të kërkonin rishqyrtim ose devijim nga konkluzionet e dhëna në ato ekspertiza paraprake. Për rrjedhojë, pretendimet e ankuesit lidhur me trajtimin e operatorëve të tjerë ekonomikë vlerësohen të pabazuara.

Mbështetur në arsyet e lartcekura, ekspertit shqyrtues vlerëson se, sa i përket rivlerësimit të kontratave të ngjashme të ankuesit, Autoriteti Kontraktues nuk ka realizuar një analizë të plotë dhe të dokumentuar për të gjitha kontratat e dorëzuara dhe nuk ka përdorur në mënyrë konsistente institutin e sqarimeve sipas nenit 59.2 të LPP-së. Për këtë arsye, pretendimi në këtë pjesë vlerësohet pjesërisht i bazuar, duke pasur parasysh njëkohësisht se mosdorëzimi i dokumentacionit për kontratën specifike nga ana e ankuesit ka kufizuar verifikimin për atë kontratë të veçantë.

Ndërkaq, sa i përket pretendimeve për trajtim të pabarabartë dhe standarde të dyfishta ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë, këto çështje janë trajtuar dhe vlerësuar më herët nga ekspertit shqyrtues dhe janë konfirmuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së; në mungesë të elementeve të reja, këto pretendime vlerësohen të pabazuara.

Pretendimi Ankimor Nr. 4:

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 60 të LPP-së, pasi nuk ka respektuar dispozitat që kërkojnë që vlerësimi i ofertave të bëhet duke u bazuar së pari në përgjegjshmërinë e tenderuesve dhe vetëm më pas në çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme. Sipas ankuesit, AK ka vepruar në mënyrë të kundërt me këtë parim, duke shpallur fitues një OE që, megjithëse ka çmimin më të ulët, është i papërgjegjshëm dhe nuk i plotëson kriteret thelbësore të dosjes së tenderit.

Ankuesi thekson se oferta e tyre përmbush të gjitha kërkesat e DT-së dhe duhej të ishte cilësuar si ofertë e përgjegjshme, ndërkohë që ata posedojnë edhe çmimin më të ulët krahasuar me të gjithë tenderuesit e tjerë që mund të konsiderohen të përgjegjshëm. Në këtë rrethanë, AK ka qenë i detyruar që sipas nenit 60 të LPP-së t'i shpallte ata fitues të kontratës.

Sipas ankuesit, mosrespektimi i këtij rendi të detyrueshëm të vlerësimit – së pari verifikimi i përgjegjshmërisë e më pas krahasimi i çmimeve – e ka shtyrë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 60 të LPP-së dhe ka çuar në marrjen e një vendimi të pabazuar dhe të padrejtë për shpalljen e fituesit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 4:

Sipas nenit 60 të LPP-së, kur kriteri i vlerësimit është “çmimi më i ulët”, kontrata i shpërblehet tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, pasi paraprakisht të jetë kryer vlerësimi i përgjegjshmërisë në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Rrjedhimisht, zbatimi i nenit 60 është i kushtëzuar drejtpërdrejt nga rezultati përfundimtar i vlerësimit të përgjegjshmërisë së ofertave.

Nga Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) rezulton se, në fazën aktuale të procedurës, oferta e grupit “N & B SH.P.K.; BM Group SH.P.K.” është cilësuar si oferta e vetme e përgjegjshme me çmimin më të ulët të poentuar, ndërsa ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë, përfshirë atë të ankuesit, janë vlerësuar si të papërgjegjshme. Në këto rrethana, aplikimi i nenit 60 nga ana e AK-së është mbështetur në këtë rezultat të vlerësimit të përgjegjshmërisë sipas nenit 59 të LPP-së.

Megjithatë, siç është trajtuar në kuadër të Pretendimit Ankimor Nr. 3, janë konstatuar mangësi në mënyrën e rivlerësimit të ofertës së ankuesit, veçanërisht në aspektin e kontratave të ngjashme dhe përdorimit të instrumentit të sqarimeve. Po ashtu, për të njëjtën procedurë janë paraqitur edhe ankesa të tjera nga operatorë të tjerë ekonomikë, të cilat lidhen me vlerësimin e përgjegjshmërisë së ofertave. Këto rrethana tregojnë se rezultati aktual i pasqyruar në formularin B58 mbetet i lidhur ngushtë me procesin e rivlerësimit dhe shqyrtimit ankimor në vazhdim.

Në këtë kontekst, çështja e zbatimit të nenit 60 të LPP-së nuk mund të trajtohet në mënyrë të shkëputur nga vlerësimi përfundimtar i përgjegjshmërisë së ofertave sipas nenit 59 të LPP-së. Për rrjedhojë, në këtë fazë të procedurës, nuk mund të konstatohet se neni 60 është shkelur si dispozitë e veçuar dhe e pavarur, përderisa statusi i përgjegjshmërisë së ofertave mbetet ende objekt rivlerësimi.

Për këto arsye, Pretendimi Ankimor Nr. 4 nuk mund të vlerësohet i bazuar si pretendim i pavarur në këtë fazë të procedurës, ndërsa çështjet thelbësore të ngritura nga ankuesi adresohen në kuadër të vlerësimit të përgjegjshmërisë së ofertave dhe zbatimit të nenit 59 të LPP-së.

Pretendimi Ankimor Nr. 5:

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 72 të LPP-së, nenin 38 të RRPP-001/2022 dhe nenin 10.1 të UOP-001/2023, meqë nuk ka respektuar detyrimet ligjore dhe këshilluese që burojnë nga këto dispozita. Sipas ankuesit, AK ka vepruar në kundërshtim me obligimin për të kërkuar sqarime të nevojshme dhe gjithëpërfshirëse lidhur me dokumentacionin e ofertës së tyre. Në vend që të kërkonte sqarime për të gjitha kontratat e prezantuara në listën e projekteve të realizuara, AK është fokusuar vetëm në një kontratë të vetme, ani pse ekzistonin paqartësi të mëdha lidhur me të gjitha kontratat e tjera që përbëjnë bazën e dëshmive të tyre

kualifikuese.

Ankuesi thekson se mosrespektimi i këtyre dispozitave ka rezultuar në refuzimin e tenderit të tyre pa bërë asnjë përpjekje për të kërkuar sqarim apo plotësim ligjor të dokumenteve të ofruara dhe pa dhënë asnjë arsyetim se pse kontratat e tjera nuk janë pranuar si të rregullta. Kjo qasje, sipas ankuesit, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 72 të LPP-së, i cili ndalon refuzimin e ofertave për shkak të paqartësive të korigjueshme dhe kërkon përdorimin proporcional të sqarimeve.

Në të njëjtën mënyrë, AK ka shkelur edhe nenin 38 të RRPP-001/2022, i cili e obligon që çdo paqartësi në dokumentacionin e ofertës të trajtohet përmes kërkesës për sqarime, si dhe nenin 10.1 të UOP-001/2023, i cili u kërkon autoriteteve kontraktuese të sigurojnë trajtim transparent dhe të barabartë gjatë procesit të vlerësimit të dokumenteve kualifikuese.

Sipas ankuesit, refuzimi i tenderit të tyre pa respektuar këto dispozita dhe pa kërkuar interpretim apo sqarim të kontratave të tjera të dorëzuara e ka shtyrë AK-në drejt shkeljes së plotë të kornizës ligjore të prokurimit publik.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 5:

Pretendimi i ankuesit lidhet me përdorimin e institutit të sqarimeve dhe me pohimin se Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarime të nevojshme dhe gjithëpërfshirëse për dokumentacionin e ofertës së tij, duke u fokusuar vetëm në një kontratë të vetme dhe duke refuzuar ofertën pa trajtuar kontratat e tjera të listuara.

Neni 72 i LPP-së, neni 38 i RRPP-001/2022 dhe neni 10.1 i UOP-001/2023 synojnë që ofertat të mos refuzohen për shkak të paqartësive të korigjueshme dhe që Autoriteti Kontraktues të përdorë institutin e sqarimeve në mënyrë proporcionale, transparente dhe të barabartë.

Nga dokumentacioni i dosjes rezulton se Autoriteti Kontraktues ka iniciuar kërkesë formale për sqarim lidhur me një kontratë specifike nga lista e projekteve të realizuara të ankuesit. Nga përgjigja e ankuesit, e datës 30.10.2025, rezulton se ai ka zgjedhur të mos dorëzojë dokumentacion shtesë për këtë kontratë, duke argumentuar se kriteri i përvojës së ngjashme është tashmë i përmbushur përmes kontratave të tjera dhe se kjo çështje është trajtuar në vendimin paraprak të OSHP-së. Edhe pse ky qëndrim i ankuesit është i arsyetuar nga perspektiva e tij, mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar ka kufizuar mundësinë e verifikimit të drejtpërdrejtë të kësaj kontrate nga ana e AK-së.

Megjithatë, kjo rrethanë nuk e përjashton detyrimin e Autoritetit Kontraktues që të analizojë në mënyrë të plotë dhe jo selektive edhe kontratat e tjera të listuara nga ankuesi dhe, në rast paqartësish, të përdorë institutin e sqarimeve në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë dokumentacionin përkatës. Nga vendimi i rivlerësimit nuk rezulton se për kontratat e tjera është dhënë arsyetim i qartë dhe i dokumentuar lidhur me mospranimin e tyre, çka tregon se instrumenti i sqarimeve nuk është shfrytëzuar në mënyrë të plotë dhe proporcionale.

Në këto rrethana, ndërkohë që nuk qëndron pretendimi se Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar fare sqarime, vlerësohet se përdorimi i këtij instrumenti nuk ka qenë i njëtrajtshëm dhe gjithëpërfshirës, ashtu siç kërkohet nga neni 72 i LPP-së, neni 38 i RRPP-001/2022 dhe neni 10.1 i UOP-001/2023. Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit vlerësohet pjesërisht i bazuar, në aspektin e mungesës së një trajtimi të plotë, proporcional dhe të arsyetuar të dokumentacionit të ofertës,

duke marrë parasysh njëkohësisht se vetë ankuesi nuk ka bashkëpunuar plotësisht në procesin e sqarimit për kontratën specifike për të cilën është kërkuar dokumentacion shtesë

PËRFUNDIMI

Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit dhe analizën e mësipërme, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e OE ankues është e bazuar.

Nga shqyrtimi rezulton se Autoriteti Kontraktues, gjatë rivlerësimit, nuk ka siguruar një analizë të plotë, të njëtrajtshme dhe të dokumentuar të kontratave të ngjashme të ankuesit, si dhe nuk ka përdorur në mënyrë konsistente instrumentin e sqarimeve sipas nenit 59 të LPP-së, çka ka cenuar parimin e trajtimit të barabartë sipas nenit 7 të LPP-së.

Ndërkohë, për pretendimet që lidhen me ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë dhe përgjegjshmërinë e OE-së së shpallur fitues, këto çështje janë trajtuar më herët në raportet paraprake të ekspertit shqyrtues, të cilave Paneli Shqyrtues i OSHP-së u ka falur besimin e plotë, dhe në mungesë të elementeve të reja nuk ekziston bazë për rishqyrtim të tyre.

Për rrjedhojë, rekomandohet kthimi i çështjes në rivlerësim, në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të kryejë një vlerësim të plotë, të arsyetuar dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AGRO INVEST 1” SH.P.K Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1180 ka vlerësuar se:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Operatori Ekonomik AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha; Multi Business Group ka paraqitur ankesë kundër Kuvendit të Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”, duke pretenduar se është eliminuar padrejtësisht gjatë rivlerësimit, ndonëse sipas tij, pas vendimit të mëparshëm të OSHP-së ka mbetur ofertuesi me çmimin më të ulët të përgjegjshëm në garë. Ankuesi thekson se AK ka kërkuar specifikime teknike dhe dokumente që nuk janë të parashikuara në Dosjen e Tenderit, si dhe ka vlerësuar gabimisht ofertën e tyre si “me çmime jo normalisht të ulëta”, pavarësisht dorëzimit të sqarimeve dhe dëshmive për formimin e çmimeve.

Gjithashtu, ankuesi pretendon se vendimi për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim është i paarsyetuar dhe në kundërshtim me nenin 62.2 të Rregullores për Prokurim Publik dhe parimet e nenit 108/A të LPP-së, duke mos trajtuar në mënyrë të plotë pretendimet e tyre dhe duke mos e zbatuar në mënyrë korrekte vendimin e mëparshëm të OSHP-së për rivlerësim. Me këtë ankesë kërkohet anulimi i vendimit të AK-së, kthimi i lëndës në rivlerësim sipas kërkesave ligjore dhe vlerësimi i ofertës së tyre si ekonomikisht më e favorshme.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet e paraqitura nga OE “AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha; Multi Business Group” kundër Kuvendit të Komunës së Prishtinës në kuadër të aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”. Pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, dokumentacionit të ofertave, vendimeve të mëparshme të OSHP-së, raportit të Komisionit të rivlerësimit, vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si dhe dokumenteve të paraqitura nga ankuesi, eksperti paraqet më poshtë analizën vijimore për

secilin pretendim të ankesës.

Pretendimi Ankimor Nr. 1:

OE ankues pretendon se AK nuk është përgjigjur në mënyrë të plotë dhe të argumentuar ndaj pretendimeve të paraqitura me Kërkesën për Rishqyrtim të datës 14.11.2025. Sipas ankuesit, vendimi i AK-së për refuzimin e kësaj kërkesë është tepër i përgjithshëm dhe deklarativ, nuk i trajton drejtpërdrejt çështjet e ngritura, shtrembëron gjendjen faktike dhe nuk merr në konsideratë provat konkrete dhe argumentet mbi kundërligjshmërinë e eliminimit të ofertës së tyre.

Ankuesi vlerëson se me këtë qasje AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 paragrafi 2 të RrPP-së dhe nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të cilat kërkojnë që vendimi administrativ të jetë i arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të mjaftueshme mbi faktet dhe dispozitat ligjore të zbatuara, si dhe se neni 108/A i LPP-së është zbatuar në mënyrë të gabuar në këtë rast. Duke mos dhënë arsytim substancial dhe duke mos u përgjigjur konkretisht në pretendimet e paraqitura, ankuesi konsideron se vendimi i AK-së është i paarsyetuar dhe i kundërligjshëm.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1:

Eksperti shqyrtues ka analizuar Kërkesën për Rishqyrtim të datës 14.11.2025 dhe Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.11.2025. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se AK ka nxjerrë vendim brenda afatit ligjor dhe ka dhënë një përgjigje formale ndaj kërkesës për rishqyrtim. Megjithatë, thelbi i pretendimit të ankuesit nuk lidhet me mungesën e përgjigjes si e tillë, por me cilësinë dhe mjaftueshmërinë e arsytimit të këtij vendimi.

Nga analiza e përmbajtjes së vendimit vërehet se Autoriteti Kontraktues ka ritheksuar në mënyrë të përgjithshme arsyet fillestare të eliminimit, pa u ndalur në mënyrë substanciale dhe të individualizuar të pretendimet konkrete, argumentet dhe provat e paraqitura nga OE ankues në Kërkesën për Rishqyrtim. Në veçanti, nuk rezulton të jetë dhënë një shpjegim i qartë se për çfarë arsyes sqarimet dhe argumentet e parashtruara nga ankuesi janë konsideruar të pamjaftueshme apo të pabazuara.

Një arsytim i tillë, i paraqitur kryesisht në formë deklarative, nuk e përmbush në tërësi nenin 62 paragrafi 2 i Rregullores për Prokurim Publik dhe neni 48 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të cilat kërkojnë që vendimi administrativ të jetë i arsyetuar në mënyrë të plotë, të qartë dhe të kuptueshme për palën, duke pasqyruar lidhjen ndërmjet fakteve të konstatuara, provave të shqyrtuara dhe dispozitave ligjore të zbatuara. Po ashtu, në mungesë të një trajtimi të tillë të individualizuar të pretendimeve, nuk mund të konstatohet se është zbatuar në mënyrë të plotë qëllimi i nenit 108/A të LPP-së, i cili synon sigurimin e një rishqyrtimi efektiv dhe real në nivel të AK-së.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues vlerëson se, ndonëse AK ka vepruar formalisht duke dhënë përgjigje ndaj Kërkesës për Rishqyrtim brenda afatit ligjor, arsytimi i vendimit nuk rezulton i mjaftueshëm për të konsideruar se pretendimet e OE ankues janë trajtuar në substancë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 62.2 të RrPP-së, nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 108/A të LPP-së. Për rrjedhojë, Pretendimi Ankimor Nr. 1 vlerësohet i bazuar në pjesën që lidhet me mungesën e arsytimit të detajuar dhe të argumentuar të vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Pretendimi Ankimor Nr. 2:

OE ankues pretendon se AK nuk ka kërkuar me FDT që ofertuesit të bashkëngjisin specifikime teknike, katalogë apo ndonjë dokument tjetër dëshmuar për produktet e ofruara, prandaj eliminimi i tij për “mungesë specifikimesh teknike” është i pabazuar. Ai thekson se në Fletën e të Dhënave nuk përmendet asnjë kërkesë e tillë, ndërsa në Aneksin 1 thuhet vetëm: “Sipas përshkrimit teknik – Paramasës dhe skicave të projektit të bashkëngjitura në DT”. Sipas ankuesit, nga asnjë dispozitë e DT-së nuk mund të kuptohet se kërkohet dorëzimi i dokumenteve shtesë për specifika teknike dhe, përderisa ai ka nënshkruar paramasën për secilin pozicion, është zotuar t’i zbatojë punët sipas kërkesave teknike të AK-së.

Për ta forcuar këtë qëndrim, ankuesi sjell shembuj nga disa aktivitete të tjera të ngjashme të po të njëjtit AK, ku me FDT janë kërkuar shprehimisht katalogë, dëshmi nga prodhuesi, mostra apo dokumente të tjera për specifikat teknike; ndërsa në këtë rast nuk ka asnjë formulim të tillë. Ai vlerëson se, duke e eliminuar ofertën vetëm pse nuk janë dorëzuar specifikime teknike që nuk figurojnë në DT, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 40.12 dhe 40.13 të RrPP-së, sipas të cilëve tenderuesi nuk mund të përjashtohet për kërkesa që nuk janë të specifikuara në njoftim/dosje të tenderit dhe komisioni vlerësues duhet të krahasojë ofertat vetëm sipas kritereve të përcaktuara në këto dokumente. Për këto arsye, OE ankues kërkon që eliminimi i tij mbi këtë bazë të vlerësohet si i kundërligjshëm

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2:

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, Dosjes së Tenderit (DT/FDT) dhe arsyetimit të eliminimit, vlerëson se çështja kryesore lidhet me faktin nëse Dosja e Tenderit ka paraparë detyrim të shprehur që operatorët ekonomikë të bashkëngjisin “specifikime teknike”, katalogë apo dokumente të tjera dëshmuar si dokumente të veçanta të ofertës. Nga shqyrtimi i DT-së rezulton se dokumentet që duhet të dorëzohen me tender janë të përcaktuara në nenin 19.1, pa paraparë kërkesë për dokument shtesë të këtij karakteri. Ndërkohë, Aneksi 1 përmban vetëm përshkrimin teknik “sipas paramasës dhe skicave të projektit të bashkëngjitura në DT”, duke reflektuar se specifikimet janë të hartuara nga vetë AK dhe shërbejnë si bazë për realizimin e punëve, e jo si kërkesë për dorëzim të dokumenteve shtesë teknike nga ofertuesit.

Në këto rrethana, nuk mund të konstatohet ekzistenca e një detyrimi të qartë dhe të publikuar për operatorët ekonomikë që të dorëzojnë dokumente të veçanta “specifikime teknike/katalogë”, dhe për rrjedhojë eliminimi i OE-së me arsyetimin se “nuk ka dorëzuar specifikimet teknike” përbën vendosje të një kërkesë të re pas hapjes së ofertave, e cila nuk gjen mbështetje në DT/FDT. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenet 27 dhe 28 të LPP-së, që kërkojnë qartësi dhe përcaktim paraprak të kërkesave në dosjen e tenderit, si dhe me nenin 40.12 të RrPP-së, që ndalon përjashtimin e tenderuesve për kërkesa të paspecifikuara në dokumentet e tenderit, dhe me nenin 40.13 të RrPP-së, që obligon komisionin vlerësues të krahasojë ofertat vetëm sipas kritereve/kërkesave të publikuara.

Po ashtu, neni 59.4 i LPP-së përcakton se tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me kërkesat e njoftimit dhe të DT-së, duke mos lejuar kritere shtesë gjatë vlerësimit. Në këtë kontekst, edhe nënshkrimi i paramasës nga OE për secilin pozicion përforcon zotimin formal për realizimin e punëve sipas specifikimeve të AK-së, në formën e parashikuar nga vetë DT.

Referimi i AK-së në Udhëzuesin Nr. 001/2023 nuk mund të zëvendësojë mungesën e një kërkesë të qartë në DT/FDT dhe nuk mund të krijojë detyrime shtesë për operatorët ekonomikë jashtë dokumenteve të tenderit. Nëse AK ka pasur paqartësi faktike lidhur me paraqitjen e ofertës, këto do të mund të adresoheshin përmes sqarimeve sipas nenit 59.2 të LPP-së, pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës. Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi Ankimor Nr. 2 është i bazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 3:

OE ankues AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha SH.P.K.; Multi Business Group SH.P.K. pretendon se nuk ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta dhe se vlerësimi i AK-së në këtë drejtim është i pabazuar. Ai sqaron se me datë 20.10.2025 AK i ka dërguar Formularin B41 për pozicionet 1, 3, 4 dhe 5 të paramasës (piketimi i parcelave – 0.50 €/copë; demolimi dhe largimi i rrethojës ekzistuese – 15.50 €/m; furnizimi, punimi dhe montimi i rrethojës – 75 €/m; furnizimi dhe montimi i derës për këmbësorë/automjete – 10 €/copë), duke kërkuar arsyetim për dyshimin mbi çmimet jo-normalisht të ulëta. Ankuesi thotë se më 21.10.2025 i ka kthyer AK-së përgjigje të detajuar, duke sqaruar secilin pozicion veç e veç në përputhje me nenin 61.2 të LPP-së dhe nenin 41, paragrafi 8 të RrPP-së.

Në lidhje me pozicionin 1 (piketimi i parcelave ku do të vendoset rrethoja, 0.50 €/copë), ankuesi shpjegon se matjet kryhen nga një gjeodet i angazhuar tashmë nga kompania, me pajisje në pronësi, pa kosto shtesë me qira, dhe ka bashkëngjitur deklaratën e gjeodetit Agron Shabani si provë. Për pozicionin 2 (demolimi dhe largimi i rrethojës ekzistuese, transporti në deponi – 15.50 €/m), edhe pse ky pozicion nuk ishte shënuar si “jo-normalisht i ulët”, ankuesi përsëri jep arsyetim: kompania ka makineri të veta për prishje e transport, deponi të afërt me të cilën ka kontratë shërbimi (KMDK), dhe kosto reale e tyre është më e ulët se çmimi i ofertuar, duke bashkëngjitur kontratën me KMDK SH.A.

Sa i përket pozicionit 3 (furnizimi, punimi dhe montimi i rrethojës – 75 €/m), OE paraqet llogaritje të detajuar të elementeve të rrethojës për 1 m linear (profilet metalike 60x60, 40x40, 20x20, betonimi, lyerja, fuqia punëtore), ku rezulton kosto rreth 54.80 €/m, pra sipas tyre me një marzh të mjaftueshëm fitimi mbi çmimin e ofertuar. Ata theksojnë se furnizimi bëhet nga prodhues vendorë, ndërsa montimi kryhet nga stafi i përhershëm i kompanisë, çka ul koston shtesë. Për pozicionet 4 dhe 5 (furnizimi dhe montimi i derës për këmbësorë dhe automjete – 10 €/copë), ankuesi argumenton se çmimi 10 € mbulon vetëm punën dhe lyerjen, sepse profilet metalikë janë në stok nga një kontratë e mëparshme e përfunduar me të njëjtin AK (“Ndërtimi i strehimoreve – parku i qenve – Negociuar”), dhe bashkëngjit fotografi të profileve si provë se materiali ndodhet realisht në magazinë.

Ankuesi thekson se, pavarësisht këtyre sqarimeve të hollësishme dhe provave dokumentare, AK me Njoftimin e Vendimit të datës 11.11.2025 ka konkluduar se çmimet e ofruara “mbesin jo bindëse”, pa shpjeguar konkretisht pse arsyetimet nuk pranohen dhe pa bërë analizë në bazë të kritereve të nenit 61.2 të LPP-së dhe nenit 41.8 të RrPP-së (ekonomia e procesit të prodhimit, kushtet e favorshme, disponueshmëria e pajisjeve, stoku i materialeve, etj.). OE pretendon se AK ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim me nenin 54 të LPP-së, duke mos marrë në konsideratë as deklaratën e datës 13.11.2025, me të cilën ata shprehen të gatshëm që sigurimi i ekzekutimit të kontratës të rritet përtej 10% të vlerës së kontratës, nëse AK e konsideron të nevojshme për të garantuar zbatimin. Në fund, ankuesi vlerëson se tenderi i tyre i plotëson kushtet e nenit 40.6 të RrPP-së për tender të përgjegjshëm dhe se refuzimi i ofertës për “çmime

jo normalisht të ulëta” përbën shkelje të nenit 7 dhe 59.1 të LPP-së, si dhe diskriminim ndaj tyre, prandaj kërkon nga OSHP që ky vlerësim të shpallet i pabazuar.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3:

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të Formularit B41 të datës 20.10.2025, përgjigjes së OE-së të datës 21.10.2025, Njoftimit mbi Vendimin të datës 11.11.2025, deklaratës së OE-së të datës 13.11.2025, si dhe Kërkesës për Rishqyrtim të datës 14.11.2025 dhe vendimit refuzues të Autoritetit Kontraktues të datës 17.11.2025, vlerëson si vijon:

Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se AK ka inicuar procedurën për verifikimin e çmimeve potencialisht “jo-normalisht të ulëta” në pajtim formal me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik, duke i kërkuar OE-së sqarime për disa pozicione konkrete të paramasës. OE ankues, brenda afatit ligjor, ka dorëzuar një përgjigje të detajuar, duke sqaruar formimin e çmimeve për secilin pozicion veç e veç dhe duke u mbështetur në elemente që ligji i njej si faktorë relevantë për vlerësimin e çmimeve, përfshirë economicitetin e procesit të punës, disponueshmërinë e pajisjeve dhe stafit, përdorimin e materialeve nga stoku ekzistues, si dhe llogaritje konkrete të kostove.

Megjithatë, nga shqyrtimi i Njoftimit mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues rezulton se vlerësimi i këtyre sqarimeve nuk është shoqëruar me një arsyetim të individualizuar dhe të verifikueshëm. Autoriteti Kontraktues është kufizuar në konstatimin e përgjithshëm se arsyetimet e OE-së “mbesin jo bindëse”, pa shpjeguar konkretisht se cilat elemente të paraqitura nuk janë pranuar, pse ato nuk janë konsideruar të qëndrueshme dhe mbi çfarë baze faktike apo krahasimore është arritur në përfundimin se çmimet janë realisht jo-normalisht të ulëta. Në vendim mungon analiza krahasimore me tregun, me projekte të ngjashme apo me kosto referuese, si dhe mungon lidhja e qartë ndërmjet fakteve të konstatuara dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 61.2 të LPP-së dhe nenin 41.8 të RrPP-së.

Neni 54 i LPP-së kërkon që vendimet e Autoritetit Kontraktues të jenë të arsyetuara në mënyrë të qartë, të plotë dhe të kuptueshme, në mënyrë që palët të mund të verifikojnë ligjshmërinë dhe objektivitetin e vendimmarrjes. Në rastin konkret, niveli i arsyetimit të dhënë nuk e përmbush këtë standard, pasi nuk demonstroi se sqarimet e OE-së janë shqyrtuar në mënyrë substanciale dhe nuk jep bazë të mjaftueshme për të justifikuar refuzimin e tyre.

Lidhur me deklaratën e OE-së të datës 13.11.2025, me të cilën shprehet gatishmëria për rritjen e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, eksperti shqyrtues vlerëson se ky element, megjithëse tregon vullnet për garantim të zbatimit të kontratës, nuk mund të ketë ndikim vendimtar në vlerësimin e përgjegjshmërisë së ofertës. Sigurimi i ekzekutimit përfaqëson një kërkesë që duhet të jetë e paraparë paraprakisht në Dosjen e Tenderit dhe nuk mund të përdoret as si bazë për pranimin automatik të ofertës, as si arsye për të anashkaluar detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të kryer një analizë objektive dhe të dokumentuar të çmimeve.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues vlerëson se, ndonëse Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë hapat formalë të inicimit të procedurës për verifikimin e çmimeve potencialisht jo-normalisht të ulëta, nuk ka ofruar një arsyetim të mjaftueshëm, të dokumentuar dhe të verifikueshëm për refuzimin e sqarimeve të paraqitura nga OE ankues. Në mungesë të një analize konkrete faktike dhe ekonomike, nuk mund të konstatohet se vlerësimi i çmimeve është kryer në përputhje me standardin e kërkuar nga nenet 61.2 dhe 54 të LPP-së dhe neni 41.8 i RrPP-së.

Për rrjedhojë, Pretendimi Ankimor Nr. 3 vlerësohet i bazuar, në aspektin e mungesës së arsytimit substancial, objektiv dhe të verifikueshëm nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë vlerësimit të çmimeve potencialisht jo-normalisht të ulëta.

Pretendimi Ankimor Nr. 4:

Pretendimet ndaj GOE “Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.”

OE ankues pretendon se GOE “Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.” është eliminuar me të drejtë nga Autoriteti Kontraktues, pasi sipas tij ky grup nuk i plotëson kushtet për t’u konsideruar ofertë e përgjegjshme në kuptim të nenit 40.6 të RrPP-së. Sipas ankuesit, GOE nuk ka arritur të argumentojë para AK-së realizueshmërinë e çmimeve të ofertës, nuk ka dëshmuar lidhjen e tyre me çmimet e tregut dhe me kostot reale të pajisjeve, dhe posaçërisht sa i përket pozicionit 2, ka ofertuar çmime që sipas ankuesit janë nën koston minimale të pajisjeve, duke treguar se çmimet janë të papërputhshme dhe jo të zbatueshme në praktikë.

Ankuesi po ashtu i referohet edhe Vendimit të OSHP-së nr. 2025/0660, përmes të cilit sipas tij është konstatuar se CV e z. Lavdim Bibaj është paraqitur pa nënshkrim, ndonëse nënshkrimi ka qenë kërkesë e qartë e Dosjes së Tenderit. Sipas ankuesit, kjo përbën mospërmbushje të drejtpërdrejtë të kërkesave të DT-së, dhe në bazë të nenit 10.1 të Udhëzuesit të Prokurimit Publik, AK nuk ka detyrim të kërkojë informacion shtesë kur dokumentet e dorëzuara janë qartazi të papërputhshme me kërkesat e tenderit. Në këtë kuptim, ankuesi konsideron se AK ka qenë i drejtë në eliminimin e GOE-së për mospërputhje administrative.

Në përfundim, OE ankues pretendon se oferta e GOE “Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.” është administrativisht e papërgjegjshme dhe nuk duhet të merret si ofertë e vlefshme në procesin e vlerësimit, dhe rrjedhimisht nuk mund të krahasohet me ofertën e tij.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 4:

Eksperti shqyrtues, pas analizës së pretendimeve të OE ankues dhe dokumentacionit të lidhur me këtë rast, sqaron fillimisht se çështja e përgjegjshmërisë së GOE “Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.”—përfshirë aspektet administrative dhe vlerësimin e çmimeve të ofertës—është trajtuar në një ekspertizë të veçantë, të hartuar në kuadër të ankesës së paraqitur nga vetë ky GOE. Për të siguruar koherencë profesionale dhe shmangie të trajtimeve paralele, kjo ekspertizë, e cila vlerëson përputhshmërinë me nenin 40.6 të RrPP-së, do t’i bashkëngjitet Panelit Shqyrtues së bashku me këtë raport.

Bazuar në gjetjet e asaj ekspertize, nuk është konstatuar që oferta e këtij GOE-je është administrativisht e papërgjegjshme apo se ekzistojnë mospërputhje formale të natyrës që do të çonin në eliminim automatik. Prandaj, pretendimi i OE ankues se ky GOE “me të drejtë është eliminuar” dhe nuk mund të merret si pikë krahasimi në vlerësim, nuk gjen mbështetje në analizën profesionale të kryer.

Lidhur me pretendimin se çmimet e ofertës së këtij GOE-je janë jo normalisht të ulëta dhe e bëjnë ofertën të papërgjegjshme, eksperti shqyrtues konstaton se problematika e trajtimit të çmimeve potencialisht jo normalisht të ulëta nga Autoriteti Kontraktues paraqitet në mënyrë të ngjashme si për ofertën e OE ankues, ashtu edhe për ofertën e GOE “Muhamet Muçiqi; HARST

Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.”. Edhe pse AK ka ndërmarrë hapat formalë (kërkesa për sqarime me B41 dhe pranimi i përgjigjeve), vendimi përfundimtar nuk përmban një arsyetim të plotë, të dokumentuar dhe të verifikueshëm që të tregojë se analiza është kryer në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të RrPP-së. Në mungesë të një arsytimi të tillë, nuk mund të konkludohet se oferta e këtij GOE-je është realisht jo normalisht e ulët dhe, për rrjedhojë, e papërgjegjshme në kuptim të nenit 40.6 të RrPP-së.

Eksperti vëren se vlerësimi i zbatueshmërisë së çmimeve, në përputhje me parimet e LPP-së, mbetet përgjegjësi thelbësore e Autoritetit Kontraktues dhe duhet të pasqyrohet përmes një arsytimi të qartë dhe të dokumentuar. Në këtë kuadër, pretendimet e operatorëve ekonomikë lidhur me ofertat e njëri-tjetrit mund të shërbejnë si rrethana shtesë informuese, por nuk mund të zëvendësojnë analizën zyrtare të AK-së sipas nenit 54 të LPP-së.

Sa i përket referencës së ankuesit në vendimin e OSHP-së nr. 2025/0660 lidhur me CV-në e z. Lavdim Bibaj, eksperti vëren se kjo çështje ka qenë subjekt i shqyrtimit të plotë në atë procedurë: eksperti i angazhuar ka dhënë vlerësimin e tij profesional dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së I ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit në vendimin përfundimtar.

Duke u mbështetur në ekspertizën e veçantë për GOE “Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.”, si dhe në faktin që vendimi i OSHP-së nr. 2025/0660 ka trajtuar tashmë çështjen e CV-së në pajtim me kërkesat e DT-së, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi Ankimor Nr. 4 nuk është i bazuar..

PËRFUNDIMI

Mbështetur në analizën e dokumentacionit të procedurës, pretendimeve të OE ankues dhe arsytimit të Autoritetit Kontraktues, eksperti shqyrtues vlerëson se një pjesë e konsiderueshme e çështjeve të ngritura nga ankuesi – veçanërisht ato që lidhen me vendosjen e kërkesave të paparashikuara në DT dhe mungesën e arsytimit të plotë për çmimet potencialisht jo normalisht të ulëta – gjejnë mbështetje në legjislacionin për prokurim publik.

Nga shqyrtimi del se AK nuk ka siguruar një arsyetim të plotë, të dokumentuar dhe të verifikueshëm në përputhje me nenin 59.4 dhe nenin 54 të LPP-së, si dhe me nenet 40.12 dhe 40.13 të RrPP-së, veçanërisht në raport me trajtimin e çmimeve të ofertës së OE ankues dhe pretendim për “mungesë specifikimesh teknike”. Për këto arsye, pretendimet për mungesë të arsytimit dhe aplikim të kërkesave të papublikuara janë të bazuara.

Në raport me GOE “Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.”, nga ekspertiza e veçantë e hartuar për atë GOE dhe nga fakti se çështja e CV-së së z. Lavdim Bibaj është trajtuar tashmë në vendimin e OSHP-së nr. 2025/0660, nuk del ndonjë element që të vërrë në pikëpyetje përgjegjshmërinë administrative të këtij operatori në kuptim të nenit 40.6 të RrPP-së.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe rekomandon që çështja të kthehet në rivlerësim, në mënyrë që AK të sigurojë një proces tërësisht transparent dhe të arsyetuar, në përputhje me nenet 1, 6, 7, 54 dhe 59.4 të LPP-së, si dhe me dispozitat përkatëse të RrPP-së.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të

LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Paneli shqyrtues po ashtu ka gjetur se të gjitha ankesat janë parashtruar lidhur me të njëjtin aktivitet të prokurimit pra kanë të njëjtin objekt dhe për këtë arsye mund të trajtohen si rast i unifikuar dhe të shqyrtohen përmes këtij vendimi në kuptim të nenit 16 të rregullores së punës së OSHP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesave të dorëzuar sqaron se konstatimet në raportet e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportet e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportet e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorëve ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE “Muhamet Muciqi BI” me nr. 2025/1168, Paneli Shqyrtues ka gjetur se OE ankues ndër të tjera është eliminuar për shkak se deklarata nën betim nuk është plotësuar në mënyrën e duhur. Në raportin e ekspertit shqyrtues sqarohet se pretendimi ankimor (me të cilin kundërshtohet arsyeja eliminuese) është e bazuar për faktin se në deklaratat nën betim operatorët ekonomik kanë të drejtë që të vendosin logot e tyre. Mirëpo në rastin konkret nuk është fare kontestuese e drejta e vendosjes së logove. Kjo për faktin që OE ankues nuk ka vendosur fare logo në deklaratën e tij nën betim (dhe as që është eliminuar për këtë arsye). OE ankues është eliminuar për faktin që deklarata nën betim nuk është plotësuar në mënyrën e duhur. Më konkretisht, Paneli Shqyrtues ka gjetur se OE ankues nuk e ka shënuar emrin e plotë të përfaqësuesit në deklaratën nën betim. Duke marrë parasysh faktin që deklarata nën betim është kusht administrativ, plotësimi i rregullt dhe i plotë i këtij formulari është kërkesë e domosdoshme për secilin aktivitet të prokurimit. Prandaj Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin ekspertës shqyrtuese në këtë pikë, mirëpo ka gjetur se pretendimi ankimor është i pabazuar ndërsa arsyeja eliminuese sipas njoftimit mbi vendimin e AK – letrës standarde për

tenderuesin është e saktë.

Tutje, sa i përket arsyes tjetër eliminuese lidhur me çmimet jonormalisht të ulëta, Paneli Shqyrtues fillimisht ka gjetur se nuk është kontestues fakti që AK e ka zhvilluar procedurën inter partes me OE ankues në kuptim të nenit 41 par. 2 të RRPP. Megjithatë Paneli Shqyrtues ka gjetur se arsyeja eliminuese konsiston në ofertimin me çmime jonormalisht të ulëta në disa pozicione të paramasës siç janë poz. 2, 3, 4 dhe 5. Në këtë drejtim, Paneli Shqyrtues ka gjetur se OE ankues për pozicionin nr. 2 ka ofertuar me një çmim prej 10 cent (0.1 euro) për 1m². Ky pozicion ka të bëjë me *“Demolimi dhe largimi i rrethojës ekzistuese shtyllave dhe themeleve të shtyllave të rrethojës. Në pozicion përfshihet edhe transporti dhe deponimi i tyre në lokacionin e përcaktuar në autoriteti kontraktues”*. Fillimisht Paneli Shqyrtues pajtohet me interpretimin e ekspertit shqyrtues ku thuhet se vlerësimi i çmimeve jonormalisht të ulëta është ekskluzivisht diskrecion profesional i autoritetit kontraktues. Në anën tjetër, në raportin e ekspertit shqyrtues ky pozicion dhe këto çmime të ofertuara nga OE ankues nuk janë trajtuar fare. Prandaj Paneli Shqyrtues nuk i ka falur fare besimin ekspertës shqyrtuese as lidhur me këtë pikë. Kjo për faktin se çmimi prej 10 cent për 1 m² që në dukje (*prima facie*) është jonormalisht i ulët. Parimisht një çmim i tillë nuk do të duhej të mjaftonte as për transport dhe aq më pak për demolimin dhe largimin e shtyllave të rrethojës dhe themeleve të tyre. Ngjashëm vlen edhe për pozicionin nr. 3, 4 dhe 5 të paramasës. Sidoqoftë, sipas të gjeturave në sistem AK ka kërkuar sqarime nga OE ankues lidhur me këto çmime në kuptim të nenit 61 të LPP-se, dhe nenit 41 par. 2 lidhur me nenin par. 8 dhe par. 9 të RRPP. Vlen të theksohet që përmes nenit 41 par. 8 dhe par. 9 të RRPP është përcaktuar se OE me rastin e ofrimit të sqarimeve mbi një çmim që dyshohet nga AK si jonormalisht i ulët, duhet të shpjegohen elementet si në vijim: *“ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimit të aktivitetëve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara; elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profited”*. Në rastin konkret, Paneli Shqyrtues vlerëson që OE ankues me rastin e sqarimeve shtesë të kërkuara nga AK për çmimet e dyshuara si jonormalisht të ulëta, nuk ka ofruar sqarime mbi të gjitha pikat e evidentuara si më sipër sipas nenit 41 par. 8 dhe par. 9 të RRPP, dhe sidomos jo sa i përket çmimit lidhur me pozicionin nr. 2 të paramasës prej 10 cent (0.1 euro) për 1m². Në këtë kuptim, Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin ekspertës shqyrtuese në këtë pikë, mirëpo ka gjetur se pretendimi ankimor është i pabazuar ndërsa arsyeja eliminuese sipas njoftimit mbi vendimin e AK – letrës standarde për tenderuesin është e saktë. Sa i përket pretendimeve të këtij OE ankues lidhur me tenderuesin e rekomanduar, Paneli Shqyrtues vlerëson që përderisa oferta e vet OE ankues është e papërgjegjshme, i njëjti nuk ka mundësi të manifestoj asnjë interes material në raport me këto pretendime prandaj nuk mund të dëshmohet as i palë e interesuar në kuptim me nenin 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP dhe në raport me këto pretendime. Sidoqoftë, në raportin e ekspertit shqyrtues janë përmendur disa vendime të kaluara të OSHP dhe është thënë që tenderuesit të rekomanduar mund t’i mungojnë disa pajisje mirëpo ekspertja nuk ka treguar se për cilat pajisje bëhet fjalë dhe nuk ka cituar saktë cili vendim me cilën frazë çka ka konstatuar! Sidoqoftë, Paneli Shqyrtues ka gjetur se AK ka kërkuar disa sqarime shtesë në kuptim të nenit 72 të LPP ashtu që tenderuesi i rekomanduar ka ofruar këto sqarime dhe ka arritur që të bindë autoritetin kontraktues se oferta e tenderuesit të rekomanduar është e përgjegjshme dhe janë përmbushur të gjitha kërkesat e DT. Për këtë arsye Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin ekspertës shqyrtuese as në këtë pikë, mirëpo ka gjetur se edhe kjo pike e pretendimit ankimor është e pabazuar. Nga sa u tha më sipër Paneli Shqyrtues ka

gjetur se ankesa e OE “Muhamet Muçiqi B.I.” me nr. 2025/1168 duhet të miratohet vetëm pjesërisht.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE “Via Egnatia shpk” me nr. 2025/1170, Paneli Shqyrtues ka gjetur se ky OE ankues është eliminuar për faktin që kontratat/referencat e prezantuara nuk janë të ngjashme me aktivitetin e prokurimit sipas kërkesës së DT ndërsa dokumenti me emërtimin “Lista e kontratave Infrastruktura shpk” nuk është plotësuar si duhet pasi që te kontrata me titull “Vendosja e gardhit mbrojtës të lumit Shkumbi” mungon emri i plotë i blerësit, emaili i blerësit, numri i telefonit të blerësit. Me rastin e kërkesës për sqarime lidhur nga AK, nuk është ofruar kontrata dhe referenca lidhur me këtë kontratë. Në anën tjetër, në raportin e ekspertit nuk është përfshirë fare kjo pjesë. Prandaj Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin ekspertit shqyrtues lidhur me këtë pretendim, por ka gjetur se arsyeja eliminuese nga AK është e saktë. Sa i përket konstatimit të ekspertës shqyrtuese ku thuhet që AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë edhe për kontratat tjera, Paneli Shqyrtues thekson që për të eliminuar një OE si të papërgjegjshëm nga një aktivitet i prokurimit mjafton që të mos përmbushet vetëm 1 kërkesë e DT në kuptim të nenit 59 par. 4 të LPP Shqyrtues ka gjetur se ankesa e OE “Via Egnatia shpk” me nr. 2025/1170 duhet të miratohet vetëm pjesërisht.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE “Agro Invest 1 shpk” me nr. 2025/1180, Paneli Shqyrtues ka gjetur si vijon: Arsyet eliminuese të OE konsistojnë në faktin që janë ofruar çmime jonormalisht të ulëta sidomos për poz. 1, 3, 4 dhe 5. Si shembull për poz. 4 dhe 5 është ofertuar vetëm me nga 10 euro ndërsa për poz. 1 është ofertuar vetëm me 50 cent (0.5 euro). Paneli Shqyrtues fillimisht ka gjetur se nuk është kontestues fakti që AK e ka zhvilluar procedurën inter partes me OE ankues në kuptim të nenit 41 par. 2 të RRPP. Vlen të theksohet që përmes nenit 41 par. 8 dhe par. 9 të RRPP është përcaktuar se OE me rastin e ofrimit të sqarimeve mbi një çmim që dyshohet nga AK si jonormalisht i ulët, duhet të shpjegohen elementet si në vijim: *“ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara; elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profited”*. Në rastin konkret, Paneli Shqyrtues vlerëson që OE ankues me rastin e sqarimeve shtesë të kërkuara nga AK për çmimet e dyshuara si jonormalisht të ulëta, nuk ka ofruar sqarime mbi të gjitha pikat e evidentuara si më sipër sipas nenit 41 par. 8 dhe par. 9 të RRPP. Në anën tjetër, në raportin e ekspertit shqyrtues ky pozicion dhe këto çmime të ofertuara nga OE ankues nuk janë trajtuar fare. Prandaj Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin ekspertës shqyrtuese as lidhur me këtë pikë. Ngjashëm vlen edhe sa i përket arsyes tjetër eliminuese lidhur me inxhinierin Agron Shabani që parimisht nuk është kontestuar fare dhe as nuk është trajtuar nga eksperti shqyrtues. Sa i përket pretendimeve të këtij OE ankues lidhur me tenderuesit e tjerë, Paneli Shqyrtues vlerëson që përderisa oferta e vet OE ankues është e papërgjegjshme, i njëjti nuk ka mundësi të manifestoj asnjë interes material në raport me këto pretendime prandaj nuk mund të dëshmohet as i palë e interesuar në kuptim me nenin 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP dhe në raport me këto pretendime. Prandaj Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin ekspertës shqyrtuese në këtë pikë, mirëpo ka gjetur se pretendimi ankimor është i pabazuar ndërsa arsyeja eliminuese sipas njoftimit mbi vendimin e AK – letrës standarde për tenderuesin vërtetohet Nga sa u tha më sipër Paneli Shqyrtues ka gjetur se ankesa e OE “Agro Invest 1 shpk” me nr. 2025/1180 duhet të miratohet vetëm pjesërisht.

Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se “*Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik*”. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e buxhetit publik të AK sikurse parashihet edhe në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e OE “Muhamet Muciqi BI” me nr. 2025/1168, si dhe ankesa e OE “Via Egnatia shpk” me nr. 2025/1170, si dhe ankesa e OE “Agro Invest 1 shpk” me nr. 2025/1180, duhet të apertovohen si pjesërisht të bazuara .

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues mbështetur në nenin 1,6,7 dhe 104 të LPP-së, mbështet B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndertimi i rrethojave te varrezave te Komunes se Prishtines” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1 pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyt e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

-Përfundim-

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues thekson faktin se Autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Poashtu Paneli Shqyrtues vlerëson sikurse parashihet në nenin 24 citoj 2. Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” si dhe neni 59 citoj 1. Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë

individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin detyësor lidhur me këtë çështje”.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Muhamet Muçiqi, VIA EGNATIA SH.P.K., " AGRO INVEST 1 " SH.P.K.**
- **Arkivës së OSHP-së:**